



SHÊZAT

LE
PLEIADI

IX, 1965 — 5-6

SHËJZAT

[LE PLEIADI]

E përkohëshme kulturore, shoqërore
e artistike

Rivista culturale, sociale ed artistica

Vjeti IX - n. 5-6 Máj-Qershtor 1965

Anno IX - n. 5-6 Maggio-Giugno 1965

Drejtor Përgjegjës
Direttore Responsabile

MATILDE MANCINELLI

Kryeredaktor - Redattore capo

MARTIN CAMAJ

Selija e Redaksisë dhe e Administratës:
Sede della Redazione e Amministrazione:

Drejtesa për letra e lajmime:
Indirizzo per la corrispondenza:

PIAZZA DELLA BALDUINA, 59

Dorshkrimet, dhe në qoftë se s'botohen,
nuk kthehen.

I manoscritti, anche se non pubblicati,
non si restituiscono.

Pronar - Proprietario

ERNEST KOLIQI

Derdhja e pajtimeve - Versamenti:

Conto Corrente Postale 1/23626

PËRMBAJTJA

Sommario

HILUSHI:

Fjala qet fjalën: Nji javë me mësues-
a arbreshë (Una settimana con gli
insegnanti italo-albanesi).

I quaderni di un Anonimo scutarino
(Tefterët e nji Shkodrani të paë-
mën).

MARTIN CAMAJ:

Udhitari maje mushkut (Il viandan-
te sul mulo).

P. VINCENZO SELVAGGI:

Una lettera inedita contro l'Arcipre-
te Masci (Nji letër e pabotueme
kundra Kryepërfitt Masci).

VASIL D. ALARUPI:

Misroku i Naumçes (Il tacchino di
Naumçe).

ANGELA CIRRINCIONE:

Immaginificazione idiomatice albane-
se (Nfytyrsim idjomatik shqiptar).

A. B. FRASNJOTI:

La pastorizia a Frascineto (Blegto-
rija në Frasnitë).

ERNEST KOLIQI:

Takimi i orës nëndë të mbramjes
(L'appuntamento delle ore nove po-
meridiane).

TUSH MURGU:

Rapsodija e nuses së mbrapësht
(Rapsodia della sposa malvagia).

P. MATTEO SCIAMBRA:

Le epigrafi sepolcrali albanesi esi-
stenti nella Chiesa Madre di Palaz-
zo Adriano (Mbishkrimet mortare në
gjuhën shqipe në Kryekishën e Pa-
lazzo Adriano-s).

Kronikë kulturore (Cronaca culturale).


Libra të lexuem (Libri letti).

Vjeti IX - n. 5-6

Anno IX - n. 5-6

Máj-Qershuer 1965

Maggio-Giugno 1965



Fjala qet fjalën

nga HILUSHI

NJI JAVË ME MËSUESA ARBRESHË

Guardia Piemontese Terme, 3 máj 1965. — Më priti në stacionin e Paola-s Inspektori i Arsimit Minisci, i ngarkuem me drejtimin e kursit rezidencjal për mësuesat arbreshë, kurs qi do të mbahet ç'prej ditës së nesërme e deri me 13 të k.m. këtu. I njëjti kurs për mësuesat arbreshë të Sicilis, u zhvillue në Palermo prej 27 marsit deri me 5 të prillit, si do t'a keni marrun vesht tue e lexue në Shëjzat. Jam i ftuem këtu me dhânë mësime letrësije shqipe. Miku i ynë Papas Françesk Solano, qi njihet mâ tepër nën pseudonymin Dushko Vetmo, do të mësojë gjuhën. Solano pajiset me një pregatitje së rrallë kulturore në datsh si hulumtues gjuhsije (linguistike), në datsh si njohës i shqipes. Zotnon si pak'e kushi djalektet e nëndjalektet gegë e toskë dhe themelisht ligjirimet e ndryshme arbreshe. Jam gjetë pranë n'orët e tija të mësimit edhe jam çuditë për njohunin e thellë qi ai ka të shqipes ndër të gjitha imtimet gramatikore e leksikore të saj.

Prej Paola në Guardia Piemontese Terme nuk janë veçe njëzete-pesë km. Inspektori Minisci, tue i grahë me kujdes makinës gjatë udhës dredha-dredha, vinte tue më dhânë të gjitha shkoqitjet mbi kurs. Do të marrin pjesë, ç'me nesër, 65 dishenta e një 10 doçenta. Paraditja u

— 145

kushtohet lekcjoneve; mbasditja punimeve në grup, të cilat kanë për qëllim përpunimin e lëndës paraqitë ndër lekcjone dhe përpilimin, nga sejcili pjesëmarrës, të një relacjoni të shkruem mbi argumentat e ditës që do t'i paraqitet Ministris s'Arasimit në Romë. Doçenta e dishenta do të qindrojnë dhetë dit në Terme me shpenzime të Ministris, e cila u paguen edhe udhëtimin. Kursi ka për qëllim të vëjë në gjendje arsimtarët arbreshë me njoftë etnogjenezën e tyne, fillet e zhvillimin e gjuhës që flasin, fazat më me randësi të historis përgjithsisht e veçanërisht t'Arbreshvet t'Italis.

Udha nga Paola në Guardia Piemontese Terme shtrihet buzë detit, të detit ndërmjet Gjinit të Polikastros dhe t'atij të Shën Eufemjes ku pasqyrohen qytete në zâ për pâmje natyrore si Maratea, Praia a Mare edhe Amantea. Në një shëj vendi këthyem kah e djathta dhe hÿmë në një grykë, që futet më parë në mes kodrash e më vonë në mes malesh, edhe vjen tue u ngushtue deri sa të qet në një lugje gjelbërore në fund të së cilës struket grumbulli ndërtesash sqimatore qarkue me lulishta, që përbân Termet e Guardia Piemontese-s. Katundi me këtë emën ngrehet i rrebët e kërcnues përmbi Terme maje një mali që zotnon lugjen edhe përmendet për një plojë a kërdi të ndodhun në të para do qinda vjetësh.

Mbasditja e vonë aty m'u duk jo aqë e freskët sa e ftoftë. Por vendi tërhiqte me blerime të njoma të shpateve e me trajta tmeruese të majeve thepa-thepa. Një thep më i frigueshëm se tjerët thirret Gishti i Djallit edhe ngrehet si një diftojs i vigânshëm guximtarisht drejtue kundra qiellit.

Shoh se pak vetë shetisin nëpër aleja stolisë anash me vullâj lulësh. Në stinën e vet Guardia Piemontese vlon me mija veruesash që aty ngarendin edhe me përfitue nga vërtytet terapike t'ujit që buron nga shkambijt me një gradë të madhe nxehtësije. Stina s'kâ fillue ende. As e shumta e pjesëmarrsavit të kursit ende s'kâ arrijtë. Tak-tuk i a behë ndonji makinë. Ndëgjoj zhurmë motorash e kumbim zânesh prej odës që m'âsht caktue. Si u pastrova e u ndreqa disë (kur vjen pleqniya ndiehet nevoja e një farë kërpitjeje...), zbrita.

Para dyerve të hôteleve, rrjeshti i makinave po vjen tue u shumë pëherë e më tepër. Koha e darkës erdhi. Kjo mbramja e parë u dallue prej një pështjellimi që përfundoi në gazmend. Drejtorija e Termeve nuk i pritte kursistat për sonte; s'ishte gati as me vende fjetjeje as me darkë. Nga shkaku i një mosmarreveshtjeje, kujtonte se kursi do të fillonte me 5 maj. Vikama e Inspektorit Minisci tronditi themelet e dy hôteleve caktue për banesë t'onë. Endej tue dhânë urdhna prej njânit hôtele në tjetrin italisht, kalabrezçe e sidomos arbërisht. Vrritte, prozhmonte, shante. Personeli sherbyes i hôteleve, i madh e i vogël, u shpërvuel. Dhomat u përgatiten. Darka u shtrive në një gjelltoe të thjeshtë por të kândëshme në skâj të Termeve, mbrapa hoteleve të mëdhaja. Ky pështjellim ndihmoi me thye akullin e takimeve të para ndërmjet njerzve të panjoftun. Si u rrjeshtuem të gjithë pranë tryezave dhe u rregullue çashtja e ushqimit, Inspektori me zâ të marrun filloi tashti me vikatë për të vû për fiye një tubë kangëtarësh me zbatitë sofrat. Darkuem tue qeshë e tue bân komentime gaztoe. Ajo darkë plot shpupurishje vjefti me zhdukë çdo diagfram ndërmjet doçentave e dishentave dhe i dha shkas një miqasimi të shpejtë, qyshë në të pa-

rën natë, ndërmjet pjesëmarrsavit të kursit. Mbrâmja kaloi në një atmosferë sympathije e përzëmërsije. Ishim lodhë të gjithë e mendojshim punën që na pritte të nesërmën. E shkruem me fjetë.

Guardia Terme, 4 maj. — N'orën 9 i a përshepteti Proveditori i Arsimit të Cosenza-s e fill në Salën e Kinot të Termeve u zhvillue ceremonija e përrimit të kursit. Inspektori Minisci tue hapë mbledhjen dhe Proveditori, kur i u përgjigj, dolën nga hullija e shprehjeve të stereotipueme dhe çeken pa ngurrim problemin e vëmjes së mësimt të gjuhës shqipe ndër të parat klasë të shkollës fillore të viseve arbreshe. Proveditori pohoi çiltas miratimin e tij dhe siguroi përkrahjen e vet pranë autoriteteve t'epura arsimore për një zgjidhje të pëlqyeshme të çështjes. Me fjalë të nxehta laudimi për komb kreshnik shqiptar e gjinde e tradita bujare arbreshe u shpreh Zoti Jannelli, drejtuer i Termeve. Mbas fjalimeve përruruese, i nënshkruemi mbajtji prolezjonin e caktuem në program.

Guardia Terme, 5 maj. — Në një kthinë të gjânë e të dritëshme të Hôtelit «Modern», më i madhi i Termeve, epen mësimet paradite. Në mbasdite kursistat ndahen në katër grupe e sejcili prej këtyne punon në një dhomë të veçantë nën drejtimin e njënit prej doçentave. Çdo lekcjon ngjatë një orë. Jepen tri lekcjone në ditë. Punimet e mbasditës ngjasin dy-tri orë. Kund një 60 mësuesa, rrjeshtue në tryeza të gjata para kathedrës, ndjekin me vërejtje ligjiratat e mësim-dhânësve. Vijnë nga vise të ndryshme të Kalabris e të Bazilikatës. Ka në mes të tyre burra flok-thijmë pesëdhjetëvjeçarë, grá të pjekuna, djelmoça e vajza. Disá erdhen këtu të shoqnuem prej të birit ase prej së bijës; disá me bashkëshortet: mësuesa të gjithë. Shumica e të pranishëmvet u përkasin katundeve të Kozentinit, këndeje e andej lumit Crati; por ka edhe përfaqësuesa të viseve arbreshe të Katanzaros e të krahinës së Bazilikatës. Spikasin në grumbull pesë a gjashtë kryetarë bashkinash e disa njerz të shquem në fshatra të lindjes. Të gjithë i a vëjnë menden lekcjoneve e marrin shënime si t'ishin nxânsa moshe së njomë. E shumta takohen për të parën herë me shoqishojnë. Ndëgjohen gjatë prâjes së mësimave pyetje drejtue njëni tjetrit me ditë si u thonë kësaj apo asaj gjâje në këtë a n'at fshat. Flasin të gjithë arbërisht. Mos me t'a marrë mendja se jë në dhë të huej!

Guardia Terme, 6 maj. — Unë e Solano japim mësim çdo mëngjes. Tjerët doçenta, që zhvillojnë thema folkloristikë, fetarë, historije lokale etj. ndërrojnë prej një dite në tjetrën. Papas Pjerin Tamburi, një studjues i ri, që tregon zotsi e shije të sigurtë në shoshitje të vlerave letrare si arbreshe ashtu shqiptare, mbajtji paradite një ligjiratë vërtë të vlefshëme mbi vetjet e krijueme prej De Radës. Edhe nesër do të flasi mbi udhë të reja të prozës tregimtare n'Europë e në Shqipëri.

Sot urdhënoi në Guardia me kalue ditën bashkë me kursista i përrnderueshmi e i përrdritëshmi Emzot Theodor Minisci, Arkimandrit i Grottaferratës. Shoqnija e këtij Prelati mende-ndritun, që i ndien në zëmër të gjallë e gjallnuesë shkumat e gjakut t'onë, solli një kënaqje të madhe në të gjithë të pranishmit. Ai deshti mîrsisht të ndëgjojë mësimet, të drekonte me në, të shtrohej në kuvend me doçenta e dishenta tue rrahë çështje arbreshe e shqiptare me vegim largpás e sidomos me afsh arbnuer kaq të zhuritun sa me prekë e përrtri në zëmërën e më të ftoftit prej nesh ndiesina të hovshëme për gjuhë e tradita t'ona.

Në mbasdite do prej nesh përsollën Arkimandritin me vizitue katundin e Guardia Piemontese-s maje malit. Ndertue si çerdhe skyferësh mbi krepa të thepisun, Guardia Piemontese s'ka veç 1100 banorë në vend, por më se 2500 emigranta n'Amerikë. Banorët me një natyrë të mbyllun jetojnë të veçuem e riejnë veshen femnore, zakonet e ligjirimin sjellë motit n'ato bjeshkë të Kalabris nga Provenca. Ikën nga vendlindja me shpëtue prej salvimeve sepse besnikë të doktrinës së Valdezvet. Nga popullsit fanatike të rretheve, një ditë prej ditësh, disa qinda vjetsh më përpara, u sulmuen trathmend. Sulmuesit vranë e prenë të gjithë mashkujt qi u gjeten në katund e një shumicë grásh. Gjaku vojti rrëkajë nëpër kalldram të rrugicave të ngushta e të priruna në tëposhtë sa me rrjedhë valë valë tue shkumbue nëpër derë të qytetit qi ç'prej asaj ploje thirret Dera e Gjakut. Sot banorët e Guardia Piemontese-s janë katolikë, por jetojnë të vetmuem pa u përzie n'asnjë mënyrë me popullsi të rretheve e hjedhin shikime t'egra ndaj visituesit e huej.

Inspektori Minisci, tue bertitë pajadá me zâ të shkyem, drejton kursin tue punue ç'prej agimit në mjesnatë e përtej, i rrethuem me ndihmësa. E ndien përgjegjësín e madhe qi randon mbi të. Për të parën herë Ministrija e Arsimit organizon një kurs të tillë. Ásht një nderë e madhe qi autoritetet përkatëse u bájné Arbreshvet. Jo të gjithë në sfera t'epura shtetnore e shohin me sý të mirë këtë nisjativë. Një shfaqje e pavend, një qendrim i gabuem, një interpretim dijekeq mund i a-këpusin hovin në t'ardhëme përsritjes së kësaj nisjative. Por Inspektori i ynë, tue bërtitë në kupë të qiellit, herë nga idhnimi herë nga gëzimi, din t'i mbajë frëjt me dorë të sigurtë. E të gjithë e ndihmojnë, e të gjithë e duen.

Guardia Terme, 7 maj. — Sa çohem prej shtratit në mëngjes, hapi dritoren e dhoma mbushet me fllad të kulluet i cili vjen nga maja e maleve i përziem me ngjelmësinën e detit qi nuk shifet por ndiehet i afërm, i mshefun prej kodrave në fund të luginës. Marr frymë tue e thithë me hurma të gjatë at ajr të shëndoshtë maluer e detar të mbarrsun me erurina bimësh të ndryshme. Shijoj me andje këndellse, nëpër frymëmarrje, ámëzën e mëngjesit qi shkelqen kristaluer nën kupën e qiellit të kálthër. Heshtja e plotë, thye nga ndonji zhurme qi mbytë largësija, m'a ngushullon shpirtin e acaruem nga rrapama e potera e qytetit. Shpirti e thithë at heshtje njashtu si mushkënit àjrin e freskët. Qe, do hapa po fillojnë të kumbojnë ndër aleja, përposhtë. Nisë lëvizja e ditës. Ndëgjohen zânë qi flasin arbërisht. E më shkon mendja te Shqipnija. Më përkujtohen zgjimet e mija në Thethë e në Kolgecaj e n'Iballe. Si na dënoi kështu fati m'e kalue jetën në mërgim, larg dheut qi na shënjoi Perendija si vend banimi në këtë botë? Ah, qiell i Shqipnis, i vetmi ti qi na ngushullon sýt... Në këtë mëngjes, larg këndeje, shtrihesh i ámbël mbi pullaz të shtëpis ku linda e qi s'ásht më e ime, mbi male e mbi fusha, mbi fshate e mbi qytete qi dikur qenë për mue lámë veprimtarije plot fryt e log mbledhësh miqsore në përzëmërsi të të cilave u kredhte shpirti tue u begatë me ndiesina bujare. Larg meje lulzojnë tashti prendvernat e Shqipnis. Gjillesa e tyne dikur më ndezte në gjak dishire ndër marrjesh guximtare e m'i dhuronte mendes frymzime muzikore të flatrueme, tue báz me lulzue mbrënda meje vetit më të mshefta e të zgjedhuna. Shpërthente

gazmendi melodioz nga të gjitha gävërsat e kurmit e nga të gjitha fije-
 zat e trûnit. Ti këndojshe në zëmrat t'ona, o mûj shqiptar! Sot heshtin
 për në bylbylat e kopshtijeve të lulzuese të tueja. E nën qiell të huej
 në na shporon zëmrrën malli i mûjit t'and! Por në mjerim të zî, prap
 fati nuk po na lën pa një rreze ngushullimi. Qe, këtu, faleminderës Zo-
 tit, kumbon shqipja an'e kand në këto dit. E janë afër katundet arb-
 reshë ku burra e grá presin miqët me të bukurat shprehje uruese të
 gjuhës s'onë. E, qe, se i Madhi Zot m'a dha rasën t'u flas mbi letrësin
 t'onë kësaj aradhje fisnike arsimtarësh qi dihten me ruejtë nëpër
 rrymbë të kavaljetave tharmet mâ të shtrëjta t'ethnicitetit arbnuer.
 E kjo mbledhje burrash e grásh, qi ndiejnë ndër dej tue value gjakun
 e përbashkët iliro-thrak, i jep edhe natyrës për rreth fytyrë e frymë
 shqiptare. Shqipnija e përpajnoi një degë të veten në ket dhé mikpri-
 tës, e një copë bote shqiptare u përtri në këto vise, ku na sot lirisht
 shmallohemi tue i zbutë mbrënda nesh trishtimet e mërgimit. Por,
 erdhi koha e lekcionit. Të presin. Ngrehu, Hilush: zbrit poshtë edhe
 ec kah kthina e mësimeve me shpirt djaloshar qi të vlonte përmbrënda
 kur u delshe para nxânsave të dashun n'Institutin Tregtar t'Ujit të
 Ftoftë në Vlonë e në Gjimnaz të Shkodrës. Ndoshta pse sot në sý më
 ndritte drita e prendvernave të dikurshëme të Vlonës e të Shkodrës
 edhe më kumbonte në zâ dalldija e të parave përpjekje arsimtare të
 mija, mësimi i im u ndërpré shpesh me duertrokitje të denduna.

Mbas meje foli Mauro, Shënmitrjoti plot entuzhazëm për çdo
 shfaqje shqiptarizmi, mbi kolegjin e Sh'Adrianit në Shën Mitër. Tre-
 goi mjaft hollsisina mbi kët çashtje qi ende s'njifeshin. U duertrokit
 me nxehtësi.

Mësimet vazhdojnë rregullisht. Cena e ndjeksave të thekë zëmrrën.
 Shum prej këtyne vëllazënvet t'onë nuk dijshin kurrgjá as mbi Shqipni
 as mbi Shqiptarë. Vetëm emni i Skanderbegut kumbon në mende të tyne.
 Njofn legjendat qi e rrethojnë at emën, por asnji ngjarje historike të
 vërtetueme. E tashti çuditen e krenohen me kënaquni të dukëshme tue
 marrë vesht se ka dokumenta të vjetër letrarë, se letrësija e jonë nisë
 në shekullin XV, se kemi një seri humanistash e vjerrshatarë e proza-
 torë shqiptarë e arbreshë. Spiegimet mbi jetën e veprat e De Radës,
 të Naimit e të Fishtës i presin e presin me duertrokitje të rrastra. Sqarohet në
 ta gjaku shqiptar e ndritë. Mësimet mjeshtrore të Solano-s i vëjnë në
 gjëndje me lexue shqip. Kapërcejnë me zëll pengimet e alfabetit të
 Monastirit. Tue lexue, i përcapin fjalët e fjalit shqipe me një andje
 krenare. E interesimi shtohet. Lypin lajme mbi botime shqipe e mbi
 ato italisht qi flasin për Shqipni.

Katundet arbreshë n'Itali javë 80 me numër. Mâ tepër se gjymssa
 e tyne flasin ende shqip. Të gjitha krenohen për origjinën arbnore.
 Për shum kohë banorët e katundeve të Kalabris, grumbulli mâ i madh,
 nuk njoftën ato të Molizës ase të Puljes ase të Sicilis e anasjelltas.

Guardia Terme, 8 maj. — Sot dhaçë mësimin e fundit mbi histori të
 letrësis. Ndër pesë mësimë vizatova një panoramë të botës shqiptare.
 Mbasnesrit me plotsue njohjen e kësaj bote, do të më xavendojë Lek-
 tori i zëllshëm i Katedrës shqipe të Romës, Prof. Giuseppe Gradilone,
 i cili me lexime e komentim copash të zgjedhuna, sidomos nga auktorët
 arbreshë, do të skalisi mâ gjallnisht vlerat letrare t'ona. Për çdo mbrá-
 mje mësuësat më rrethojnë e më pyesin për Shqipni e për kushtet në

të cilat sot ajo jeton. Thithin fjalët e mija si të dishruem. Edhe Solano, natyrë e drejtpeshueme, qi as nuk xehet as nuk ftofet udob, tregon çiltas në fytyrë kënaqjen për fryte qi po ep kursi. Arriji mbasdreke edhe Adv. Albino Greco, drejtori i « Zgjimit » (Risveglio), nji Arbresh i ri të tanë zjarm për shqiptarizëm e përparim të kulturës s'onë. Biseduem me të mbi çashtje qi kemi për zëmër.

Guardia Terme, 9 maj. — Të gjithë kursistat t'udhëhequn nga Inspektori, me nji varg makinash qi gjarpënon nëpër grykë në t'ulun kah deti tue bā poterë me trumbetim klaksonash, po nisën për në Shën Sofi t'Epirit, ku sot kremtohet shkelqimisht dita e Shën Atanazit, pajtuer i katundit. Aty, mbas ceremonive fetare, do të zhvillohet shfaqja e « Vëllamjes arbreshe (probatinlleku) me kângë e valle këndue e gërshetue nga qinda vajzash veshë në kostume të shkelqyeshme qi janë lavdi e krenija e Italo-shqiptarvet.

Kush nuk i ka pá me sý këto valle arbreshe nuk mund i a përftjyrojë vetes bukurin mahnitëse të tyne. Enden vashat rrotull-ó tue e luejtë shtatin me hijeshi të madhnueshme e në lëvizje të tyne shkelqejnë mundafshat e ngjyrëshëm të veshës krenare. Na kumtuen se sot në Shën Sofi do të këndojnë e do të vallzojnë veshë në kostum mâ shum se njëqind vasha sofioe ase ardhë nga katundet arbreshe për rreth.

Unë mbeta këtu me Solano-n e Tamburi-n. Mbasdite i a arrini nga Roma edhe Prof. Gradilone. Mâ vonë erdhi edhe Papas Matrangolo, kryepriifti aktiv i Acquaformozës, i cili në famulli të vet ka krijue shkolla e strehë jetimore e ndërmarrije tjera bāmirse të dëja për nji qytet të madh. Matrangolo do të flasi mbi rytin byzantin qi ndjekin shumica e Arbreshvet të kësaj krahine.

Guardia Terme, 10 maj. — Gradilone mbajti ligjiratën e vet dhe pësh me sý të mij sa tronditje solli ndër ndëgjuesat leximi i vjerrshave prej auktorësh arbreshë, qi e shumta e kursistave ndëgjoishin për të parën herë. Ato vetë çuditën për visare qi ruen në gji komuniteti i tyne. Hapet për ta nji orixont i ri. Dita kaloi në punë e në bisedime të dobishme e të kandëshme.

Mbas darke prof. Emilio Tavolaro, i palodhuni vlerësues i folklorit arbresh, na ftoi në nji salë të madhe të Hotelit « Sirenetta » për nji shfaqje muzikore-vallzuese. Në të vërtetë u gjeta pranë nji mbledhjeje qi Inspektori e Tavolaro e mësuesat kishin përgatitë për të nderue të nënshkruemin. Ishte e mbramja natë e qindrimit t'em në Guardia. Shka të thom? Merrnje me mend për mallimin qi më rroku dhe dridhjen qi m'a përshkoi shtatin kur nji tubë vajzash erdhen para meje e mueren me zâne harmonjoze shpirt-tronditëse hymnin kombtar « Rreth flamurit të përbashkuar » e kângën « Ejani këtu ». Mandej nisen e kënduen e hogen valle arbërisht. E më drejtuen fjalë qi më fatbardhësuen. Por nuk më deji krenija aqë sa të mendojshem se ato nderime m'i kushtonte mue ajo aradhe fisnike Arbreshesh të hijeshme. Kuptova se unë, i vetmi Shqiptar Shqipnije aty, përfaqsojshem në sý të tyne dheun e të Parvet. Ata në personin t'em të padënjë shifshin Arbërin e dishruem në pesëqind vjet mërgimi. Nderojshin në mue të bukurin atdhë të zanafilles, rrethue gjithënji me dritën e lavdis së Skanderbegut. Unë, n'at mall qi mrekullisht ngjatë tash pesë shekuj, shifshem e ndiejshem sigurin e nji rilindjeje së njëmendët të Shqipnis.

I QUADERNI DI UN ANONIMO SCUTARINO

(continuazione dal n. 1-2, 1965)

... Vorrei dare esempi delle nostre canzoni, ma non lo credo necessario, poichè i canti di Agesilao, degli eroi di Sulina, di Marco Botzaris, di Colocotroni, di Ali Pascià di Giannina, di Scanderbegh, di Costantino, di Garentina, di Ymer Agà, del famoso visir di Scutari Mahmud Pascià, che si rese indipendente dalla Porta, di Pasvan Oglu, di Milo Shino, di Lek Dukagini ed altri innumerevoli, che si conservano quali tante gemme nel popolo per tradizione di padre in figlio sono assai noti.

Avendo parlato alquanto della lingua albanese, come pure dei canti e delle rapsodie popolari, dirò ora brevemente sul commercio che l'Albania conserva attualmente con i paesi limitrofi; parlerò pure sulla speciale legge medioevale della vendetta, che da noi vige, come sull'altra dell'ospitalità.

L'Albania, e per la sua posizione geografica, e per la ricchezza dei suoi terreni, e delle sue miniere, sarebbe il primo paese agricolo, industriale e commerciale, se fosse nelle mani di un'altra potenza civilizzatrice, ma nelle mani del Turco, inerte e pigro, è uno dei più abbandonati paesi. Vi sono vastissimi terreni incolti, boschi sterminati ancora vergini che non sono di nessuno, tesori che la mano dell'uomo non ha ancora profanato. Lo squallore e la miseria regna nel paese dell'abbondanza, e sembra un deserto quello che dovrebbe essere una terra promessa per noi. Abbandonati a noi stessi nulla facciamo: veramente il Turco nulla quasi si prende, ma nulla ci dà, ed è più che spende per questa provincia, venendo i denari dal tesoro, che quello che ricava; poi le rendite stesse per grandezza le dona ai cittadini. Non vi sono quei pesi e quelle tasse opprimenti che sono in Europa e specialmente in Italia, non vi è la leva militare per noi, non vi sono regie privative; appena paghiamo in minime proporzioni le decime dei prodotti; qualche piccola *nisamie* effimera; ma non vi è giustizia e siamo costretti a farla da per noi, non vi sono strade nè ferrate nè provinciali, nè carrozzabili, nè fluviali, si viaggia sempre su veloci destrieri; il paese languisce senza concorso di forestieri, senza incoraggiamento per la pastorizia e per l'agricoltura; tutto viene dall'estero, non abbiamo neppure una fabbrica. Quella che offre l'Albania ai paesi stranieri, e che noi esportiamo in una data quantità sono la lana, le pelli, il somaco; e questo commercio si fa maggiormente con Trieste e Venezia; la seta, e questo commercio si fa con Milano, ed anni addietro era abbondante, ora offre poco. Il legname, il grano, il granone ed il bestiame, specialmente cavalli e buoi, da noi sono a massimo buon mercato, comprandosi il miglior cavallo per 80 franchi, ed il miglior bue per 60, e questo commercio si fa coll'Italia meridionale; poi un po' di pesci salati col Montenegro e colla Serbia: ecco tutto il nostro commercio.

Mentre abbiamo miniere di zolfo, di ferro, di piombo, di sale, di soda e

di carbone fossile, e di tanti altri metalli, e niuno se ne cura. Vi sono frutta abbondantissime meno gli agrumi, vi è l'olio, il vino e cose tutte per il solo consumo locale, potendosi invece commerciare su vasta scala. Acque abbondanti, laghi e fiumi, che potrebbero servire per l'irrigazione, formandone canali, e come forza motrice per molini e macchine, ed invece sono di danno al paese, perchè lasciate liberamente scorrere nei propri letti senza argini, ogni tanto inondano e desolano le città e campagne. La sola Scutari ha quattro acque che la circondano, il lago detto di Scutari di più di venti miglia di lunghezza, che ci unisce al Montenegro, il fiume Drino, che gira per tutta quasi l'Albania dividendosi in Drino nero e bianco, il fiume Bojana che sbocca nell'Adriatico alla foce di S. Nicolò, ed il torrente Kiri impetuoso. La città ha 42 gradi di latitudine, di un clima moderato, con tante acque, con immensi terreni e vegetazione che si perde a vista d'occhio, dovrebbe essere un Eden, ed una delle più fiorite città del litorale Adriatico, superiore alle rocciose ed aride città dalmatine, di Zara, di Pola, di Spalatro, Sebenico, Ragusa e Cattaro, ed uguale alle sorelle delle isole Ionie, ed è appena conosciuta nel mondo commerciale; perchè vi domina il Turco, distruttore per natura, che distrusse e rese squallide e deserte queste belle terre, poichè tutti conoscono l'antico adagio: che dove calpesta il piede dell'Osmanli, non cresce più l'erba.

I viveri da noi sono a massimo buon mercato, potendo uno vivere senza esagerazione agiatamente con un franco al giorno, come con 10 a Palermo; comprendosi per es. un'oca (cioè un chilo ed un quarto) di carne buona con 40 centesimi. Ho detto almeno più volte ai nostri fratelli *arbreshë*, rivolgetevi a noi a poche miglia di distanza, voi che bisogno avete di andare nella lontana America? qui pure vi sono terreni per voi, come voi nostri connazionali d'oltremare, perchè v'accoglieremo a braccia aperte, troverete un fratello ed un amico in ogni albanese, ritornate nella madre patria, portateci un poco di luce e di civilizzazione venendo dal giardino dell'Europa.

Io sono desolato nel narrare la verità, e nel mettere a nudo le piaghe del mio paese; ma noi che eravamo sì famosi per commercio pochi anni addietro (non parlo degli antichi tempi della Repubblica Veneta), ma fino a pochi anni prima delle ultime guerre; ora siamo abbandonati dopo lo smembramento fatto dal Montenegro e dopo la ferrovia fatta a Salonico per tutta la Rumelia fino a Prisrendi e talmente lasciati (in disparte) che se non venisse quasi per condiscendenza due volte alla settimana un vapore della società del Lloyd Austriaco, saremmo isolati dal resto del mondo.

Vi sono poche arti locali; e specialmente gli orefici sono in voga e i sarti e che lavorano finissimi lavori di cesello e di ricamo. Anzi trattandosi del Giubileo del Pontefice, la Congregazione Mariana fece eseguire un giglio in filograna, che piacque tanto al Papa, e lo donò alla Chiesa del Gesù come si trova nella cappella di S. Luigi esposto tuttora.

L'albanese è pieno di intelligenza e l'albanese è speculatore per natura come ogni orientale; non manca la coltura; in sei mesi per es. con un maestro italiano la banda civica imparò a suonare diverse arie talmente che il maestro stesso restò meravigliato. Gli armajuoli pure sono in voga, facendo finissimi lavori d'argento, d'oro e di madreperla per pistole e pistolette e lunghi schioppi e jatagan; perchè da noi tutti vanno armati per propria difesa e per onore.

Faccia Iddio che venga un'aurora anche per la povera Albania; post nubila Phoebus.

Giak (*gjak*) vuol dire sangue, e si usa pure metaforicamente per la legge della vendetta, il dente per dente di Mosè; quelli erano popoli di dura cervice

ed ai nostri pure si conviene. Da noi i parenti dell'ucciso prendono la vendetta sull'uccisore; di simili omicidii il governo poco o nulla s'interessa; riconoscendoli quasi legali; quando però fosse qualche pezzo grosso cerca di prendere una buona taglia.

Però la legge della vendetta privata è più terribile e più inesorabile. Uno uccide un altro per un motivo qualsiasi, ed ecco che non solo il colpevole ma tutti i parenti suoi fino al terzo grado devono interamente nascondersi; perchè i parenti dell'ucciso uccidono il colpevole o chiunque dei suoi parenti dovunque li vedono. Presa la vendetta, si pacificano come nulla fosse stato e restano anche le parti soddisfatte.

Noterò che in questa vendetta la femmina non è considerata, non godendo essa in Turchia diritti uguali all'uomo; e quindi in quei casi può fare tutti i lavori dell'uomo in commercio ed in campagna liberamente, ma i fanciulli maschi sono compresi anche in fascie. Ma la legge ha certi limiti; supponiamo che la vendetta si ritardi, allora vengono ai patti, e resta solo nascosto il colpevole e qualcuno dei suoi fratelli, a cui si assegna un punto determinato della fede (*besa*), presso di noi irremovibile. Molte volte vengono a migliori patti, e si paga in contanti l'uccisione. Un sangue costa sei borse (cioè 600 franchi), una ferita tre borse. Ma se le famiglie sono forti e potenti per ricchezza, la pace non si effettua mai, e durano odii e rancori per anni ed anni e rovine di patrimoni che si credevano incrollabili; e succede che il padre morente, conservando per venti, per trenta anni la camicia insanguinata del figlio ucciso, lascia per testamento all'altro figlio la vendetta.

Quando invece vi è pace, o anche tregua provvisoria, mangiano e bevono insieme e fanno comparità (si legano col comparatico) due parti nemiche. Questi sono costumi nel pieno secolo decimonono, nel centro dell'Europa, che li tollera.

Ahimè! se la forza della religione non avesse mitigato alquanto gli animi di quei barbari montanari, forse anche si mangerebbero tra loro, come i cannibali dell'Africa; ed i poveri Missionarii sanno quello che soffrono.

Nè i giovani possono rendersi vili per timore, poichè a colui che non ha vendicato gli si dà una rocca per filare: anzi dirò per diversione, che siccome da noi non si usano mobilia alte, come letti, tavolini, sedie od altro, secondo il costume orientale, e questo anche a Costantinopoli e nel palazzo del Gran Sultano, ma viceversa tappeti finissimi e cuscini attorno tutta la stanza; così si siedono tutti per terra nelle chiese, nei negozi, negli uffici, nelle case pure tra i gran signori; ed a tavola in cerchio colle gambe incrociate, al vile, come diceva, si offre il bicchiere dell'acquavite o del vino, sotto il ginocchio, quasi ad un indegno di restare nella società dei bravi; e quello se ha pur un tantino di rossore in volto, deve cercare il modo di rendersi ultore. E queste vendette sono uguali fra Turchi e fra Cristiani, fra Albanesi, Montenegrini, Bulgari o Rumeliotti. Però il Principe Nikita di Montenegro, persona di alto valore e merito, ha cercato di raddolcire i suoi, e fra gli Albanesi della parte turca e della Montenegrina ha radunato i capi e ne ha formato molte paci (cioè li ha rappacificati). Il Turco invece pesca nel torbido: e per togliere da noi la pena del taglione devono passare molte generazioni.

Gli estremi si toccano, e la legge dell'ospitalità è tutta all'opposto di quella della vendetta. L'ospitalità albanese è proverbiale in tutto il mondo. Uno, di qualunque nazione, lingua, religione siasi, si trova perso in campagna o fra i monti, o la sera lo ha colto durante il suo cammino, bussa alla prima porta che incontra, gli viene aperto, e viene accolto quale amico, col meglio che può offrire la casa, si uccide anche un capretto, si chiamano i vicini per tenergli com-

pagnia, lo si appella col nome di amico, domani lo si accompagna fino al confine dell'altro paese, e guai a chi lo tocca, il padrone della casa arriva a rischiare la propria vita per lui.

Nè si creda che io esageri, chè fosse pure quello un sanguinario, o ricercato dalla giustizia, o dalla vendetta privata, o debitore impossibilitato (insolvente) o qualunque peggior arnese, purchè dica *aman, n'dor tane* (ti scongiuro, nelle tue mani sono), la sua causa è assicurata; e se egli è in viaggio per passare ad altra nazione, il padron di casa lo accompagnerà al capo dell'altro paese, e così di seguito per fede (*besa*) egli viaggerà impunemente fino al confine. Incredibile dictu! a che si spinge lo spirito di fedeltà albanese. Ed è pur succeduto, che uno ha ucciso un altro, non sapendo dove rifugiarsi in quel momento di confusione, si ricoverò nella prima casa che trovò aperta, e venne accolto dal padre dell'ucciso e non se ne parlò nulla in quella sera e dormì tranquillamente; all'indomani lo accompagnò (il padrone di casa, padre dell'ucciso) fino ad un certo limite: poi il padre gli disse: « Tu eri nella mia casa e non t'ho potuto dir nulla, ora però guardati chè se tu non ti nascondi, io ti ucciderò come tu hai ucciso mio figlio ».

Vedano, signori, che popoli sono i nostri. Quando però si viaggia per diporto o per affari onorevolmente, l'ospitalità è così cordiale che incanta, come io stesso l'ho più volte provata andando per affari miei nei paesi, e lo stesso piccolo complimento (qualche moneta spicciola) ai ragazzini nel partire la mattina molte volte non l'hanno voluto accettare. Il maomettano anzi, che per gelosia, non fa vedere la donna a nessuno (è la povera donna maomettana o cristiana è completamente schiava e di questo ne parleremo altrove), in data circostanza all'amico arrivato in casa gliela presenta per fargli onore.

Un'ultima digressione. Abbiamo anche la virtù della gratitudine, e l'Albanese che una volta abbia mangiato in una casa, non la tradirà mai.

Questi sono gli albanesi, v'è un impasto di buono e di cattivo, si potrebbero rendere migliori con un forte governo: naturalmente scrivendo devo dir il bene ed il male.

Parlerò adesso di una divozione speciale che hanno sempre avuto gli Albanesi per Maria SS. sotto il titolo del Buon Consiglio, da noi detta Madonna di Scutari, si trasportò per mani d'angeli in Italia e si posò a Genazzano sopra stiano già conosce, di quella immagine miracolosa, che, staccatasi dalla chiesa di Scutari, si trasportò per mani d'Angeli in Italia e si posò a Genazzano sopra Roma verso la metà del secolo quindicesimo.

Era da antichissimi tempi tenuta in somma venerazione da tutta la Cristianità Albanese quell'immagine, che, pitturata sopra un intonaco di muro nell'abside principale della Chiesa, incantava talmente con la sua bellezza, coll'espressione materna dei suoi lineamenti, colla dolcezza dello sguardo, che molti in buona fede la credevano pitturata dagli angeli. Era il Palladio, dirò così, la divinità tutelare di Scutari e di tutta l'Albania, e spandeva a piene mani i suoi benefizi sopra tutti i sofferenti, che a Lei con fiducia ricorrevano. E gli autori contemporanei hanno piene le pagine di innumerevoli miracoli da essa operati nel dare la luce ai ciechi, l'uso delle membra agli storpi, la vita ai morti, le gioie spirituali ai peccatori; era la piscina, che non in un dato momento dell'anno, ma in ogni tempo e in ogni stagione beneficava e lavava tutti. Sarebbe superfluo dalla mia parte parlar di Maria, dopo quello che ne hanno parlato innumerevoli autori, dottori, santi. Il gran S. Bernardo e S. Alfonso De Liguori lo attestano essi, che ne dissero parole d'oro.

Dirò solo, che in quei gran trambusti di guerre Iddio ci tolse anche questo

ultimo conforto, la bella immagine, e ciò forse perchè i nostri peccati erano arrivati al colmo. Maria si sdegnò di abitare in un paese profanato, di rendersi oggetto di profanazione ai Turchi. Un triste giorno l'immagine è sparita nè si vide più, l'intonaco è tolto miracolosamente dal muro, rimane la sola nicchia, lo spazio vuoto. Che desolazione sarà stato per quei poveri cristiani in quelle circostanze così critiche, che sconforto, che ravvedimento. Due di essi i più meritevoli la scorgono, la seguono, come i Magi la stella, passano pianure e montagne, fiumi e burroni, ed arrivano fino a Roma, sempre coll'occhio ad essa fisso, quale gli Ebrei nel deserto la colonna di fumo e di fuoco di dì e di notte.

Al pari dei Magi, De Georgis e De Sclavis (così si chiamavano quei felici) arrivati a Roma non la vedono più; dimandano a tutti i passanti: avete visto la nostra immagine? Fuori di sè non sanno che fare. Sentono di una immagine miracolosa apparsa a Genazzano, corrono e riconoscono la propria. Nella loro immensa gioia vissero e morirono ai piedi di Maria, e la loro discendenza esiste tuttora a Genazzano. Anzi uno di quella famiglia ora è sindaco di quel paese. Esisteva in quei tempi una pia donna dell'ordine di S. Agostino, la beata Petranella Petruccia, tutta dedita all'ascetismo, alle sante pratiche della vita contemplativa. A lei appare Maria, e le ordina di edificare un tempio. Essa consacra tutte le sue sostanze in aspettazione della Gran Signora, che sarebbe per venire.

Terminato il tempio, le campane suonano da sé in tutta Genazzano, appare l'immagine e si posa sull'altare maggiore. Effettivamente io sbaglio; dicendo si posa, essa restò sospesa sull'altare, e da allora lo è sempre, anche adesso; e desidero che i gentili lettori notino questa circostanza speciale. Essa è sospesa, non toccando da nessuna parte, perchè non si è stabilita a Genazzano ma abita provvisoriamente in attesa di ritornare fra noi a migliori tempi. Nè questa è una illusione per noi, ma una fede, una certezza che ci alimenta che ci conforta. Maria vuole essere con noi, come Dio col popolo d'Israele, che era il suo Dio sempre, ma talvolta quando prevaricava esso lo abbandonava momentaneamente nelle mani dei nemici, finchè pentito si rivolgevano a Lui, ed Egli era sempre il suo Signore e protettore. Maria è sempre nostra, l'immagine è momentaneamente lontana da noi, che la invociamo in ispirito.

Ora hanno edificato a Genazzano una bella chiesa sontuosa, e la cappella di Maria è ornata con splendidi doni di Papi e di Principi.

I Padri Agostiniani ne hanno la custodia, ed accolgono gentilmente ogni visitatore. Io che scrivo ho avuto la fortuna fra pochi miei connazionali contemporanei, di visitare quel santuario, scrivendo il mio nome nell'album dei visitatori. Quello fu il più bel giorno della mia vita, quando fra il canto delle litanie ed il suono delle campane, potei vedere le belle fattezze della nostra Madonna; oh! non mi potea staccare di là; mi sentia attirato come il ferro dalla calamita, dimenticava la mia esistenza, le sofferenze, ogni cosa; oh! fossi morto ai piedi della nostra Madonna, piuttosto che ora trovarmene lontano.

(continua)



UDHTARI MAJE MUSHKUT

nga MARTIN CAMAJ

Shtëpija e Culit ishte e vendosun përmbi një kodër. Megjithatë ishte një banesë e vogël përdhese, dukej tue e shikue për së largut shumë e madhe, më së pari sepse gjindej në at vend si në shëj; dhe mandej, tue qenë e rrethueme nga çubat e mareve të blera, ashtu për së largu të thonte mendja se pullazi i saj ngritej përmbi një pyllë me druj të rritëshëm dhe të naltë. Më se një udhtari ia kishte rrëjtë sytë, sa të thonte ndër mend: «Nuk po eci më gjatë e po ndalem sonte me bujtë në at kullë atje maje kodrës».

Culi ishte njeri fantast dhe i pëlqente më tepër dishka që i lurtonte veshët — të thomë në një gjë të trillueme — se sa ngjarjet e sendet e bazueme në realitet. Atij s'i kishte shkue kurr nëpër mend se shtëpija e tij ia rrente sytë të huejve që e vrejshin tue kalue shpatinave ase fushës për nën. Ai ishte i bindun se bota ia kishte ndigjue zânin për burrë të mirë e kuvendtar e se, për t'i ndigjue bisedën, ndalej për një natë në plangun e tij. E vërteta ishte se miqt, sa hyjshin në oborr të asaj banese të ultë, pendoheshin përnjimend që i kishin dhanë vehtes mundim të kapeshin deri mbi at kodër. Mun ndonjani as nuk hynte mbrendë kur e diktonte se kishte përpara një kasollë përdhese, por u largonte vjedhtas e vijonte udhtimin tue mos dëshruet të hante bukë e groshë e qepë atë mbrame. E pra i zoti i shtëpisë ishte mikpritës dhe bujar në at të veten, për shkë kishte. Megjithatë njeri qyqe kalli i vetëm, përpiquej t'i shërbente mikut sâ më mirë e më mjeshtrisht, tue bisedue e shtruet tryezën. Culi dinte si kurrkush t'a mbante njerinë me fjalë e kuvend të gjallë. As rakija nuk mungonte në trollin e tij, por as rakija e Culit nuk u pëlqente miqve pse nuk ishte rrushit, por maresh. Rakija e mareve posë se ka një erë të randë, asht e tharbët si të ishte e pjekun me gjeth hardhije e jo me fryte aq të bukura në të pamë ashtu si janë maret me një ngjyrë të kuqlemtë si të ishin badema sheqeri. Rakija e mareve duket mandej se ka dhe një të metë tjetër pse shumkuj i shkakton dhimbë kreje.

Të përbujtunit në mëngjes iu donte të thonte: «Të ardhëshim për të mirë, o i zoti i shpisë!» por tue u largue pëshprite në vehte: «Në kje se ta shkeli më derën për të mirë a për të keq, më qit të pijë dhe lang verrit!»

Në një rend shoqner ku mikpritja asht doke dhe kanë, i përbujtuni i rendomët nuk kënaqet të shtijë kryet nën një strehë e të jetë mirënjohës për bukë e krypë e zemër.

Culi ishte krenar për shtëpinë e vendosun maje kodrës, pse prej oborrit të saj shtrihej shikimi më së miri mbi qytetin e Shkodrës, mbas mendimit të tij: si me e pasë në shuplakë të dorës. Kur ishte vetëm pa miq, delte shpesh në mbrame në oborr dhe vrente me kënaqje dritat e eletrikut të qytetit të largët. «Mija e mija dritash! Ndoshta

miljone llampash!» thonte me vehte. Kush e njihte Culin, e dinte se ai i zmadhonte punët. Ata që nuk e njihshin thellë kujtojshin se kanë të bájne me një njeri që s'dinte me njëhë as deri në pesëdhjetë. Kur i binte në erë se ndokush e mbante për kaq të padijshëm, e ndiente thellsisht peshën e syemjes, por u përmbante dhe viente në heshtje dhe nemte fatin e vet. «As i pasun, as i dijshëm — mendonte me vehte. — Ata që i kanë të dyja këto të mira, kishin me më thanë: hajt Cul, mos u ankò mbasi ke shëndetin, shikò se si dukesh, si ujk malit». Culi kishte nxanë me kohë të shkruej e të këndoje, por llogaritë i bënte maje gishtave.

Nji gjã nuk mund ta kuptojshin as miqt në Culin. «Ç'lezet gjen ky njeri — thojshin ata — me të kuvendë orë e orë pa u lodhë prej fillimit deri në mbarim vetëm trillime! Nuk ásht se rren qind për qind, por e bân mizën buell ase buellin mizë sidomos kur donte me ia zvoglue shoqit të kegen që i kishte ra për hise». Bindja e çudija shtohet kur vertetohej se ai nuk trillonte ase rrente për të pasë ndonji përfitim vehtjak. Shkurt, Culi ishte një njeri që trillonte njimij sende në kambë e në dorë pa ndonji qellim të caktuem.

— Mirëpo — pyeta njëherë — si sillet në mardhanje me tjerë, p.sh. në shitblemje.

— S'ka njeri mà besnik. Sa për atë ásht i drejtë dhe mund të keshë besim të plotë në të.

Kështu m'u ngjall kureshtja ta njihsha Culin mà për së afërmi.

Në atë kohë isha njeri i pa zanatë dhe sillesha kot katund në katund për të tretë merzinë. Kisha pasë fatin të më lente im atë shumë miq, prandej isha gjithkund i mirëpritun. Pse unë kisha mbetë pa një zanatë, faji nuk më binte krejt mue për hise. Unë e kisha nxanë pak shkollë, por jo aq sa të nxã një nëpunsi sado të vogël. Nga ana tjetër me atë shkollë që kisha m'u dukte përulje e madhe me kapë shatë e spatë në dorë. Unë për vehte nuk do të kisha ngurrue kurr me ia hy punës fizike, por — më thoni — shka do të kishte mendue krejt bota analfabete e malit për të tanë arsimin kombtar? Kështu qita cekën mos me bã kurrfarë pune, vetëm e vetëm për të ruejtë prestigjin e arsimtarve të vertetë. Për fatin tem si gjymsak s'po e çoj mà gjatë, mbasi s'ka të bájë mà thellë me temën që kam për duersh. Due të shtoj vetëm këtë gjã: në kohën që jam sjellë si rrugaç nëpër male e fusha të vendit tem, kam njohtë shumë njerëz për të cilët jam i shtrënguem të shkruej herë mbas here dishka. Kështu më ásht ngjallë dëshira të tregojsha takimin tem me Culin.

Kur një ditë shiut pashë tymin tue dalë nga pullazi i shtëpisë mbi kodër, vendosa aty për aty t'i bijsha mik Culi te dera. «Ditë shiut, ditë pushimit — thashë — kështu ka me pasë kohë të më rrëjë e kacarrëjë për kadalë, ngëshëm».

E gjeta tue shilue një mushk të rij nën hajat. Sa më pau, la punën dhe u përgëzue me mue që tekembramja e kisha qitë cekën t'ia msyjsha derën.

— Kam pasë miqsi të madhe me tand atë, more burrë! Shokë kemi kenë na të dy, shokë e miq përnjimend!

Ia ngula sytë për të diktue moshën e tij. Culi u kujtue pse po e vrejsha dhe pa ngurrim shtoi:

— Natyrisht, unë isha shumë më i rij se ai, por po thom, send çudi! kemi shkue mirë si të ishim kenë mocatarë.

Sa hyna mbrendë u vû në levizje për të më pritë e qitë si duhet.

Si njeri me shkollë që isha, rëndom më pyetshin shpesh herë për-bujtësit e mij se shka shkruente kalendari, a do të bâhet dimën i madh at vjetë. Prandej thashë, pa më pyetë, sa për të hapë kuvendin:

— Rrencat ase si i thonë zyrtarisht kalendarët shkruajnë se simjet ka me u bâ dimën i fortë sa me fjetë maca e mini shpinë për shpinë që mos të mërdhasin.

— Mirë iau kanë bâ kalendarve — ia mbet ai — që iau kanë një të emnin rrenca. E kam pasë ble para nja tri vjetësh një. Vjetin e parë nuk ia qelloi kurrkund, por të dytin i ra pikë për pikë në të: shi në kalendar — shi n'oborr, borë në kalendar — borë n'oborr, diell aty në të — diellë jashtë. Gjë çudi!

Mbeta pak ndër dyzash: a t'a ndreqi a mos t'a ndreqi? Poqese e ndreqi tue thanë se kalendari i vjetshëm nuk vlen për motin e tashëm, ndoshta do t'u skuqte për padijen e vet. Poqese e dijte këtë gjë dhe donte me u shitë përpara meje si njeri i trashë, atëherë delsha unë i pa krypë. Mâ mirë heshtova.

— E paske pasë ble një mushk të mirë, Cul.

— Puna e mushkut është një store e gjatë — m'a kthei mendueshëm. — Mushk i mirë sa t'a duesh. Kam punue vjet e vjet për të ble një hajvan kësi soji. — Dhe më foli gjanë e gjatë për hallet e veta.

— Tash e ke kohën edhe me u martue.

— E kam bâ edhe këtë llogarî — m'a priti — njëherë me ble mushkun e mandej me u martue. Po t'isha martue mâ parë, mushkun nuk e kishe ble kurr. A e kam mirë?

— Llogarî me mend!

— Mbas grueje mandej vijnë edhe rrëcokët dhe shpenzimet shtohen.

Culi edhe tue kuvendë me mue, trette në mendime dhe shpesh lente përgjysëm bisedën që kishte nisë.

— Shka me të diftue, more burrë! — tha tue nxjerrë një shishe rakije prej një rafti. — Send çudi! — vijoi tue ulë zânin si të donte të më tregonte dishka në besim. — Qyshë se kam ble mushkun, m'është cilë perdfa e një bote tjetër. Qyshë se kam ble mushkun ulem shpesh në qytet. Nuk dij, si pa u kujtue është tue më dalë shumë punë. Mandej është lezet i madh, mbasi të kemë krye punë në qytet, me u një të në mbrame kadalë për pjetë fushës e malit maje mushkut.

Mandej treti prap në mendime të veta dhe nis me të pijmë rakî maresh në heshtje. Në zjarmë vlonte vegshi me groshë të ré: avulli që shperthente për nën kapak gjysë të hapun më zgjonte një apetit të papritshëm. Shiu jashtë e mbi rrasat e pullazit me krizmën e njëllorshme si tiktaku i orës nuk e prishte heshtjen që zotnonte në atë shtëpi fshatare mbushë plym me rraqe: reme të varuna në mur, sheka të vjetra në krye të banesës në gjysëterr, mâ andej kosha, spata e lopata të hjedhun parregull ndër skuta.

— Përpara t'u donte me këthye kambë prej Shkodre.

— Lene se tash kthej pa u lodhë kah shpija, por maje mushkut, pa pasë nevojë të shikoj se ku vë kambën, lëshoi sytë andej e këndej e, m'a zen besë, për të parën herë në jetë shoh botë me sy.

— Mundem me e marrë me mend — ia prita.

— Se shka shoh unë maje mushkut — vijoi Culi tue u përpjekë të zgjojë në mue kureshtje — është vështirë me ta marrë mendja.

Era e fortë e rakisë së mareve më thekte flegrat e hundës.

— Ti e njeh — tha ai — katundin këtu nën në në fushë.

— Shpesh më ka ra rama edhe të bujë në at katund. Mundem me thanë se atje kam dhe shum miq e dashamirë të shtëpisë sime.

— Don me thanë ti ke pa oborrin dhe dhomën e priltjes e një ase dy shpijave, por jo krejt katundin. Qe, si është puna: katundin nën në e ndan rruga e madhe që unë e rrahi qyshë se mbaj në mend për vehte. Mb'atë anë e në këtë anë të rrugës janë gardhiqe të vjetra të mbulue me me ferra të gjata më se dy metra. Fillë mbas gardhiqeve vjen vargu i pemve e i fiqve që shtrijnë degët e shpeshta edhe mbi rrugë. Qyshë se mbaj mend për vehte kam kalue mija herësh si nëpër një rruginë përmjedis atij katundi, pa dijtë se shka është andej gardhiqeve.

— Don me thanë se tash ti maje mushkut e sheh tanë katundin.

— Nji pjesë, jo krejt. Por mjafton.

Culi ia nisi mbarë e mbarë të më përshkruejë më së pari arat e kopshtijet, ku bima e duhanit dhe e perimeve tërbohej dhe mbrrinte masa të jashtazakonshme. — E ka bënë Zoti Misir at katund — përfundoi. — Por punojnë burra e gra, i madh e i vogël, pa dijtë se shka është pushimi. U lumtë!

— Pse nuk punon edhe ti ashtu?

— Ku me punue? Ndër këto kodrina të thata? Këtu rritet vetëm çuba e mares dhe e dullisë. Mandej atyne atje poshtë u është zbutë gjaku e s'i ndigjon kurr tue u shamatue. Në bullek njerzija është e kënaqun kështu që çdo plang njeh tridhetë, katerdhetë vetë, mos më shum. Secili bënë ata shka i thotë i zoti i shpisë, plaku që si një amë bletësh urdhnon ndejë në një post në kryet të vendit. Ai nuk prek punë me dorë, por — bënë me shëj Culi tue prekë tamthin e kresë — punon me mend burri i botës.

— Nuk i ke dijtë këto punë përpara se të blejshe mushkun?

— Dishka kam ndigjue, por tjetër gjë është me pa me sy se ç'rregull ka ai katund e si e ka pa Zoti me të gjitha të mirat!

— Kështu është puna e kësaj jetë, lum Culi! — Fillova me i shitë mend një njeriut që punët e veta i dinte më mirë se unë. — Ti kur nuk kishe mushkun, nuk shihse se dikush tjetër jetonte më mirë se ti. Tash maje mushkut sheh mirë e më mirë; e iau ke lakmi tjerëve.

— Lakmi — m'a këthei — ia kam vetëm një zot shpije në at katund. Nuk është më i pasuni, por ai din më mirë se askush me i hjekë tel jetës. Emnin s'po ia përmendim. E këtë punë e kam diktue qyshë se kam ble mushkun; që, po ta diftoj fill e për pë.

Tue këthye prej qytetit para një muezit, ia ula pak frenin mushkut që të ecte kadalë rrugës që dan përmjedis katundin nën në. Aty kah mjedisi i saj, bimët e therrat cohen mbi gardhiqe aq naltë sa që vetëm tue çue kryet mund të depërtojë shikimi përmbas. Shi në këtë vend iu paraqit syve të mij përtej mes pemve një çardak i gjanë, ku pshtetun mbi jestekë pinte duhan i zoti i asaj shpi, një burrë i vjetër me një mjekërr të bardhë deri në prëhen. Në të ndejun e pashë se ai ndër mend të veta i thonte jetës a je më! Këtë gjë e diktova në sjelljet e

tija, si pinte duhan në qelibar e si shkundte herë mbas here cingaren përpara në dërrasa.

— Çudi! — ia prita. — Nji zot shpije nuk âsht kurr pa kujdese. Zakonisht kur nji zot shpije i tillë del e rrin vetëm ashtu, âsht i rânduem prej mendimesh që don me i zhvillue.

— Nji njeri i kuptueshëm si ai, nuk ka nevojë me mendue shum gjatë — tha Culi tue ndie shije kuvendit. — Ai nuk mbet gjatë vetëm. Mbas do kohe duel në çardak nji nuse e re me tabake kafje në dorë, të cilën ia vunë përpara. Unë kisha ndigjue se plaku ishte martue përpara tri vjetësh, por se kishte marrë nji grue aq të bukur nuk e dijsa!

— Nji grue aq e re dhe e bukur e martueme për nji plak! Këto janë doke të mnerëshme! Dam i madh, me të vertetë dam i madh!

— Po kje se nusja âsht e kënaqun me plakun, pse me e ankue? Prit ti se shka po të diftoj unë ty: nusja mbasi uli tabaken me kafe, vetvetin u ul e ndëj pranë plakut. Ti s'm'a zen besë, por burrë e grue që shkojnë aq mirë si ata të dy, edhe me kambë të kalit me i kërkue nuk i gjen! Dukej si mos me kenë njeri i gjallë as në katund, as në atë shpi që me ia u prishë qetsinë, por vetëm ata dy e kurrkush tjetër.

— Ç'mentalitet âsht ky i yti, lum Culi! kur ti nuk kupton se nji grue aq e re s'mundet me qenë kurr e lumtun me nji njeri aq të vjetër. Mandej, ku e din ti se kjo grue âsht aq e re dhe e bukur? Ç'ka ke mujtë me pa ti përmbi gardhiqe? Ndoshta ti ke pasë diellin e mbrames në prenim në sy e nuk të ka lanë me pa qartë.


— Jo, dielli i mbrames në prenim u kishte ra atyne të dyve, unë ishe krejt në hije.

— Kur e ndrit dielli i mbrames fëtyrën e femnes, rrëhet çdo njeri në bukurinë e saj — ia prita unë tue mbyllë këtë bisedë.

Culi duel jashtë me marrë dru për zjarmin që kishte nisë me u ulë. Tue marrë në shqyrtim kallximin e tij, vuna re se çdo gjâ e tregueme prej tij mbështetej pjesërisht në të dhana të verteta e se anat e trillueme dhe zbukurimet në përshatmenit të gjendjes së njimendët në thelb nuk e cenoshin të vertetën.

Unë i njihsha katundin e rjerzit mbi të cilët shtjellohej tregimi i Cudit, prandej diktova menjihërë se nuk i përgjigjej të vertetës se dielli i mbrames shëndritte plakun e nusen e re në çardak të shtëpisë, që ishte e sjellun me dyer kah lindja. Culi kishte prirjen e nji tregimtari të vertetë e po të kishte dijtë të shkruente trillimet e veta, do ta kishim quejtë sot shkrimtar. Nësa isha tue përtypë ndër mend këso kujtimesh, hyni mbrendë me nji tubë drushë ndër duer që në gjysë terri m'u ngjanë si të ishin nji turrë librash.

— Ku kemi mbetë? Më pyeti ai. — Nuk e kam mbarue endë storën teme. Send çudi, more burrë!... — Vijoi Culi tue u ulë me ndejë kambkryq para meje.



Una lettera inedita contro l'Arciprete Masci

di Papas Vincenzo Selvaggi

Dal carteggio di *Giovanni Canadè*, ultimo Sacerdote ammogliato di S. Giorgio Albanese, nonchè insegnante, abbiamo tratta la seguente lettera di *Giovanni Andrea Canadè*, sindaco, diretta contro l'*Arciprete Masci* e *D. Giulio Varibobba*, i quali si adoperarono con ogni mezzo per il passaggio del loro paese dal rito greco al rito latino.

Destinatario è probabilmente *Mario Comes*, nipote e amministratore del Cardinale Spinelli.

Il *Canadè* fa precedere la lettera da alcune osservazioni, che riteniamo opportuno pubblicare con il testo integrale della lettera. Egli opina che questa sia da datarsi nell'anno 1760 (?).

P. Vincenzo Selvaggi

« Dai fatti avvenuti, dagli eccidi dei pettinari e del brigantaggio, aizzato e protetto sempre dai Baroni e dalle fraterie, dall'invasione di feroci e corrotti forestieri, i quali col denaro delle chiese, e dei potenti Manutengoli della Calabria, come i Colonna per Roma, con gl'intrighi, con i narcotici e con veleni, trucidarono i temerari, soppressero i generosi, spogliarono degli averi anche i più cauti, col disseminare dissidi nelle famiglie, e dare peso alle più nefande calunnie, si può ritenere che sia rovinata la condizione indipendente di S. Giorgio Albanese. La risurrezione di questo infelice Comune messo sempre in soqquadro dalle scissure, che vi riaccessero sempre i nuovi Padroni, i quali in queste pensano continuare il loro dominio, non avverrà se non quando i successori di questi martiri generosi avranno riacquistata la loro indipendenza economica, ed uniti in sacra alleanza di mutua rivendicazione, formeranno il perno sul quale deve posare fermamente la ruota dell'azione economica, morale, civile e scientifica (sic) degli abitanti albanesi di questo derelitto paese. Come contributo alla storia delle patite sventure, trascrivo un'istanza di un Sindaco, mio antenato, favoritami da Don Ciro Marini, Arciprete di S. Demetrio Corone, e che mi diceva averla rinvenuta fra vecchie carte di famiglia. E' ad essa pervenuta dal Saccheggio del Collegio? fu furata dall'Archivio di Rossano, dove si conservava in copia? S'ignora! Il certo si è che il tempo fa venire a galla i delitti e le infamie perpetrate dagli avi di chi oggi si vede ricco e potente ».

Ecc.mo ed Ill.mo Signore.

Giovanni Andrea Canadè, Sindaco di questa terra di S. Giorgio, Umil.mo e Dev.mo Vassallo di V.a Eccellenza, umilmente La supplica a nome e vege della Comunità suddetta, come sin dall'anno 1758-59 è stata risvegliata nella Curia Arcivescovile di Rossano, una fiera contesa dal Sindaco di quel tempo per alcune innovazioni che pretendea fare Don GIULIO VARIBOBBA nella medesima, che tendevano al pregiudizio, e del rito greco, sotto la di cui purità si è vissuto da' nostri ante-

nati, dacchè vennero ad abitare in questo Regno; come pure del pregiudizio delle giurisdizioni di questa Arcipretal Chiesa, assolutamente greca, atteso che si pretendeva dal divisato Economo con l'aggiuto parimente del Sacerdote greco Don Nicola Masci sbandire da questa stessa Patria detto Santo Rito. E vedendosi l'Università suddetta inabile a resistere agli urti dei divisati due perturbatori, fu obbligata a ricorrere all'aggiuto e protezione autorevole della B.M. del defunto Purpurato; degnissimo Zio di V.a Ecc.za, allora Comendatario di questa insigne Badia, il quale con una benignità uguale alla sua propria, si degnò animarci a resistere all'innovazione dei medesimi, e ci assicurò parimente della sua protezione, come si ravvisa da diverse lettere, che si conservano registrate, in memoria del degnissimo personaggio, e si verificò il suo aggiuto; mentre col decorso della lite suddetta scorgendosi la pendenza di quella Curia Arcivescovile, a pro' dei medesimi Collegati, dubitandosi di qualche evento contrario alla ragione, stimò la B.M. di far passare la Caosa in codesta S.C. de Propaganda, dalla quale considerata l'insussistenza de' movimenti dei perturbatori, con decisive determinazioni, corroborate dal regio exequatur, si pose fine a tali controversie. E quando si sperava doversi godere quella pace, che detta B.M. seminò in questa Patria si vede presentemente nuovamente risvegliarsi tentativi di questo Signor Arciprete Masci, più scandalosi dei primi, mentre tendono non solamente la distruzione del Santo Rito, ma benanche la giurisdizione, che tiene V.E. in questa chiesa, mentre a sue intenzioni l'attuale arcivescovo havve introdotto nella medesima Chiesa Greca un altro Parroco Latino, che al presente lo fa comparire insignito con armuzia di seta a color pavanaccio, foderata di rosso, stola e tutt'altro conviene alla dignità di vero Parroco, col far esercitare funzioni tanto private che solenni, indipendenti farsi dall'Arciprete, il quale per l'antica odiosità, che teneva contro il proprio rito accordò il tutto, tanto più che questo posto si è conferito a D. Giovannandrea Masci, di lui figlio, niente curandosi delle disposizioni dei suoi Superiori di Propaganda e molto meno a quello che porta alla giurisdizione di V.a Ecc.za come patrono assoluto della suddetta Chiesa, collo *jus* in presentare l'Arciprete in caso di vacanza, smembrandola con l'aggiunta di un nuovo parroco di diverso rito, anzi per soddisfare alla sua prava idea, opera cioè in *odium auctoris*, che fu sempre la lodevole B.M. del defonto Purpurato, a cui questo pubblico professa eterne obbligazioni, come a quelle che deve a V.a Ecc.za per le difese e protezioni tenne sempre a di Lui favore. E la più segnalata grazia si spera nell'imminenti contingenze, sì per eternare i fatti di un qualificato personaggio come fu la B.M., sì perchè il tentativo suddetto offende il rispetto dovuto a V.a Ecc.za per averlo esaltato in questa dignità, e la più particolare grazia si è che questa povera Università non può resistere con detto arciprete, tanto più che gode il favore dell'Arcivescovo con lo quale molto si fida: La pendenza di detto Monsignore di Rossano potrà V.a Ecc.za scorgere dalla relazione che farà egli su tal proposito, che forse non combinerà con la Veridica si farà dal Vostro Signore Ministro. Perciò supplicandovi del suo autorevole patrocinio e benignissime grazie, con tutta profonda venerazione si umilia, chiedendovi la Santa Benedizione, pregando il Signor Iddio per l'esaltazione di V.a Ecc.za, quam Deus etc.

MISROKU I NAUMÇES

nga VASIL D. ALARUPI

Naumçeja ishte me nam për dy gjëra: si zejtar i përsosur në të bërët të këpucëveve edhe si njeri shumë i shtrënguar.

Cilkës, femrës së tijs, seç i kishte shkrepur për ca misra të njomë. Po ku t'ia gjente misrat bashkëshortes! Të vinte t'i vidhte më ndonjë arë, atë jo. Deshte t'ia bënte qejfin gruas andaj u mendua për një kohë dhe pas mendimit vendosi të niset për në Çiflik të Shamollit ku, se si i ardhni, na kishte një kushëri të largmë.

— Të më bësh hazër një torbë edhe ato gjyrmashkat e çorapeve të leshta, o grua, — i tha së shoqes të shtunën mbrëma, — nesër do të vete në Çiflik të Shamollit të të sjell ca misra.

* * *

Fshatari kushëri, që s'ia kishte parë ndonj'herë surratin korçarit kushëri, e priti ashtu si ia deshte zakoni i konakut: me të pira e gostë dhe e përcolli me torbën mbushur me misra të sgjedhur edhe një kungull nga më të shijëshmit për furrë. E tek kthehej nga Shamolli me torbën më sup, kungullin për bishti në njëren dorë e këpucët në tja-trën, mendonte se nga e se qysh qenë kushërinj me katundarin bujar po s'arrinte t'ia gjejë rrënjët. Sidoqoftë qelepirxhiu ishte me fytyrë të gëzuar se ecte me çap të lehtë (me gjyrmashkat në këmbë për të kursyer e ruajtur këpucët) e diku ia theshte një kënge ose vërshëllente ndonjë tjetër e mënëfund përfundoi: «E-mo, kushërinj, s'do mënd, jemi ngrohur ndën një diellë...».

Por ajo e diel e shënjtë, dit e mbarë për Naumçen se tek ishte larguar mjaft prej fshatit, na sheh një zog gjeldeti të vetmuar. Qëndroi dhe e vështroi me kujdes vallë mos qe ndonjë fëllëzë o ndonjë tjetër lloj shpendi. Jo, vështrimi i parë s'e qaboi, ishte misrok. Lëshoi mbërdhë, buzë një hendeku, kungullin, këpucët edhe torbën pastaj çveshi xhakën, e palosi mirë e paq dhe si e vendosi. vështroi me kujdes të madh reth e rrotull. S'dukej këmbë njeriu as edhe shtëpit e Shamollit. Luadhet ndeheshin përpara tij dyst e vetëm nga e mëngjra ishte një sërë shelgjishtash: Mali i Thatë nga veriu, Malet e Barçit nga lindja; po ç'të shëkonte aqe larg! Misroku po kulloste në një arë të korrur prej kohësh e i hidhte këmbët si me të matur çapin e bishti i ngrihej tek çukiste. Pastaj qëndronte, ngrinte kokën për pakëz e gjene i futej tokës me qip. Nj'herësh e pa Naumçen. Këtë herë qëndroi për një kohë më të gjatë duke qayrur korçarin po përsëri vashdoi të çukiturit.

Naumçes seç filloi t'i rahë zemra se gjene hódhi vështtrimn sgerminjës reth e rrotull kurgjë e kurkush s'dukej gjëkund. Ahere iu drejtua misrokut:

— Misrok!... Tuj-tuj-tuj!...

Misroku e dëgjoi. Qëndroi, ngriti kokën dhe pa lëvizur fare zu t'a vështrojë futundsin sikur deshte t'i thoshte: «pse or s'shëkon punën t'ënde?».

Naumçeja qe unjur, kishte marrë në dorë një plis e dërmoi ndë pëllëmbët e përsëri ia bëri:

— Misrok!... Tig-tig-tig!... Tuj-tuj-tuj!... edhe filloi t'i flakë, një tre hapa larg, dheun e thërmuar si për t'i dhënë të kuptojë tujkës se po i dhuronte nga m'i miri misër i Shamollit. Po zogu gjeldeti ia e merrte, ia s'e merrte vesh. Do të kishte qënë më shumë i egërt se i butë.

Pas tërë marifetevet edhe s'jalëve të kota q'i drejtoi gjeldetit zog për të hyrë në një kuptim miqësor me 'të, Naumçeja zu të bëjë çap pas çapi përpara, duke iu drejtuar tujkës tani me një si këngë, me mënyrën më të butë e më të ëmbël, më tingëllonjëse, që do t'ia kishin bërë të shoqen të pëlçasë cmire. Po, si për çudi, hiç s'i shkonin në vesh misrokut dhe nga kjo mund të kuptohej qartazi se ay shpend s'kishte pasur të bëjë me racën njerzore të pakën që kurse mori aratinë nga kuaçka miskë dhe humbi në fushën e gjërë.

Çap pas çapi Naumçeja iu afrua mjaft misrokut që dukej si i magjepsur nga kënga e korçarit, po posa që ky u derdh mbë 'të, misroku lëshoi një «klluq-klluq-klluq», u ra krahëvet edhe këmbëvet e u tregua m'i shkathët se kundraxhiu, i cili, në flakjen si më not për të përparë shpendin, ndodhesh tashi barkas n'arën e korrur ndërsà gjeldeti, i tmeruar e si me të lebetitur, hikte pa ndonjë drejtim të caktuar, nëpër ara. Naumçeja u ngrit, i hoqi një pëllëmbë të hapur fytyrës edhe gojës për t'a pastruar nga pluhri, shkundi edhe teshat nga gjoksi gjer mbë gjunjët, pastaj hodhi vështrimin ndaj misrokut dhe ia bëri:

— Ama kështu e dashke-a? — Ishte me fytyrë shumë të shkumbëzuar. Po, pa bërë hovin, mblodhi vehten dhe gjene vështroi reth e rrotull. Gjene s'pa njeri. Ahere pështyu pëllëmbët, pa ditur përsë, mori frymë duke fuskosur gjoksin, i ra me gisht strehës së shapkës dhe iu derdh misrokut. Shpendi e ndjeu të ligën dhe hiç s'qëndroi. Po ay s'qe veçse një misrok i ri e sa do të hikte... Kurse Naumçeja, goxha burrë, mbë të dyzet-e-pestat, pak m'i gjatë nga mesatarja, më tepër thatarok, me mustaqe të zeza si të spërkatura me të bardhë, hundën pisuskë, harbonte posi ndonjë atlet dhe e arriu misrokun; iu afrua njëherë dhe duke rendur i krusur mbë 'të, sgjati dorën po vetëm një dy nga pendët e bishtit të misrokut i mbetnë në pëllëmbën e mbyllur. E. si për çudi, misroku zu të rendë herë majtas, herë djathtas, e Naumçeja, hë t'a kapë këtu, hë atje, gjene u hodh mbë 'të e gjene s'e zu dot po ra barkas në tokë. Gjer u ngrit gjahtari, misroku kishte fituar largësi, e gjer u pastrua e u shkund ay, shpendi pothuaj se u afrohej luadhevet. Naumçeja ishte tani me gjak të prishur:

— «Ua! po, si or, s'qënkam i zoti të ze një zog misroku!...».

U mendua pakëz, vështroi reth e rrotull, gjene pështyu pëllëmbët, gjene fryu gjoksin, preku shapkën me gisht edhe iu derdh shpendit. Vrulli i tij ishte aq i madh sa mend u gremis në një hendek që s'vu re se mbante vështrimin mbi tujkën. Hë të bjerë këtu, hë atje, pas kapërximit dajandisi. Atje fillonin luadhet. Andej ia kishte marrë misroku. Naumçeja i qe afruar aq sa mend e kapi por shpendi hikte tani

me qipin të hapur e dukej në fund të takatit. Kundraxhiu më s'provoi të hidhet mbë 'të si kishte bërë dy herët e tjera, po vetëm i vinte pas duke rendur. S'vajtnë edhe aqë larg ndër luadhe se misroku i hapu krahët, ndeu qafën e duke hequr zvarrë këmbët e çapluara, nj'herjesh, ra në tokë më bark e mbeti më vënd. Naumçeja, duke gulçuar me gjysmë fryme, me gojën hapur e qull nga dirsët qëndroi mbë shpendin. Para se t'a kapë solli frymën në vënd. Ishte dyllë në fytyrë. Pas një çasti edhe misroku e mori pakëz vehten e sikur po bëhej gati t'ua mbathë përsëri, po Naumçeja ia shtiri tapanxhat dhe e zuri. Shpendi u përpëliti e u përpëliti po s'mundi t'i shpëtojë kapjes. Veç duke bërë ç'mos e kafshoi Naumçen në dorë dhe ay se ç'e ndjeu një të cimbithur të fortë. U zemrua korçari gjahtar pa çifte andaj e shtrëngoi shpendin në dorën e mëngjër dhe ngriti të djathtën t'a godasë. Po i ardi keq. E vu gjahun në tokë dhe pasi i shkeli të dy këmbët me podillën e tij, sgjidihi gjalmin e gjurmashkës së mëngjër e me atë lidhi pisk këmbët e misrokut.

— Tashi, hikë po munde, — i tha. Pas kësaj u sheshua për çlodhje ndërsa budallaj misrok përpëlitej që t'i shpëtonte lidhkës e të merrte përsëri çairet.

Kur u çlodh mirë, Naumçeja ardhi edhe në vehte se vu rë që ishte pa xhakë, pa torbën me misrat e pa kungullin. U ngriti me vrull, përllau misrokun për këmbësh dhe zu të vështrojë ç'anë të merrte. Këtu ngeci se jo vetëm që s'i zinte syri njeri, por teshat e tija s'dukeshin gjëkund dhe ca mornica të ftohti filluan t'i përshkojnë trupin.

«— Pu-pu!... — ia bëri. — Po tashi?!...» — Mori një drejtim nëpër ara. Eci me sy në tokë. Eci pa pushim për një kohë të gjatë...

«— Po ku or, ku i lëshova?» — ia bënte me vehte. «— Oh, un i ziu!... Do t'mi ketë vjedhur njeri. Mbase misroku qe një marifet që të më hiqte tutje e kështu të merrte plaçkat e mijja. Bobo! Un'i ziu! Ç'më gjeti!...» — vashdonte t'ia bëjë Naumçeja i vverosur. Rudhat e fytyrës së tija shënoheshin në këto çaste mumsi brazdat e aravet të posa lëruara.

«— Pu-pu ore!... Këpucët e reja, xhakën e re, pa leri të tjerat...».

E ngrithe miskën gjer afër fytyrës, e vështronte me egërsi dhe i vinte t'a pëlçiste përdhëu sa t'i pëlçiste t'ëmbilit. Po kur arrinte në çastin që të sbatojë shtytjen nga zemrimi, pendohej edhe thoshte: «— Po ç'faj ka misroku?».

Naumçeja, gjer aty, u kishte rënë an'e mb'anë aravet e një pjese të luadhevet pa gjetur teshat.

«— Po tashi?» — Qëndroi. Veshtrioi reth e rrotull e vu re se po ngrysej; kishte kërkuar më kot pothuaj tërë pradrecken.

«— Bo-bo! Ç'më gjeti mua të zinë, ç'më gjeti!...».

— Klluq-klluq-klluq!... — ia bëri nj'herjesh misroku.

Kjo e mbërtheu Naumçen në vënd. E vështrioi gjeldetin zog dhe ia bëri:

— E-mo... Ç'do të më thuash?

— Klluq-klluq-klluq!... vashdoi shpendi.

— More, e di se e ke mirë! — tha duke iu drejtuar tujkës.

Në këto çaste Naumçeja mendonte shpejt. Po të binte nata, duhej të kthehej në Korçë pa këpucë, pa xhakë e ç'ishte ca më keq edhe pa misra për të shoqen, pa lere që lere kungullin. Hodhi vështrimin nga

Shamolli dhe u nis për andej. Tek ecte i dhembti këmb e mëngjër se vu re q'e kishte humbur gjyrmashkën passi i pat nxjerë gjalmin për të lidhur këmbët e misrokut.

— Në dreq të vejë gjyrmashka!... — truahti edhe i dha vrull ecjes, megjithqë tani, me dijë të këmbës lakuriqe, zu edhe sikur të çalojë.

Eci e eci Naumçëja e mënëfund e gjeti udhën e fshatit. Pastaj prapaktheu. Ndërsa tani kthehej me kujdes, sytë katër, misroku ia bëri përsëri:

— Klluq-klluq-klluq!... Ishte errur.

Naumçëja qëndroi e se ç'u mat t'i thotë tujkës kur syt i ranë mbë guaskë të verdhë të kungullit pranë të cilit qenë këpucët, xhaka edhe torba me misrat.

— Pu-pu, ore! po mos më kishnje lajmëruar nuk do t'i kishnja parë, — i foli misrokut. E ngriti edhe e puthi. E misroku, si misrok, s'kuptoi se i hoqi një qip majës s'hundës së Naumçes sa thuaj ia gjakosi. Po kundraxhiu po dridhej nga të ftohtit andaj veshi xhakën, mbathi këpucët, hodhi torbën më sup, kapi me njëren dorë bishtin e kungullit, me tjetrën këmbët e misrokut dhe u nis për në Korçë.

* * *

Kishin shkuar disa javë nga e diela që Naumçëja solli misrokun në shtëpi. I kishte uqdisur një vënd të posaçëm prapa shtëpisë dhe bërë një qymez me drasa të vjetra të mbledhura, andej-këtej, nëpër pazar. Dhe me të shkuar të javëve, gjeldeti zog na ishte bërë goxha misrok se i zoti e ushqente me misër e me çdo ushqim tjetër që mbli-dhte të shtunavet nëpër thasë të fshatarëve.

E siç qe rritur tani, misroku bënte një bujë dreqi në ca çaste të ditës. Naumçëja kishte bërë ç'mos që t'a mbante në heshtje këtë punë të tujkës po mëhalla e ka të dëgjuarit finkeje dhe fët Ngjelkat zunë të pyesin njëra-jatrën n'u bënë veshët o në s'qenë në vehte, gjersa fqinja e së Naumçes i ardhi një ditë edhe e pyeti:

— Moj Cilkë, po paski misrok në shtëpi moj, e s'ma paske thënë?

— Uh edhe ti Maqkë... Po se mos është donjë pun e madhe. Naumçëja e bleu ca kohë të shkuara edhe më tha t'a ushqejmë për mot të ri.

— Po, si moj, m'a paske fshehur mua këtë punë? N'e njoh unë Naumçen, misroku do të ketë donjë...

— E-me, edhe ti, do t'a tregoj, po mos ia dëftesh njeriu.

— Uh, moj Cilkë, moj motër, nuk po të marr vesh. Nga mua të druesh, që jemi si motra?

Dhe Cilka, e shoq e Naumçes, i tregoi Maqkës, gruas së Gaqit, fqinjës shkuar motre, tër historin e misrokut.

Maqka e ruajti të fshehtë se lagjes nuk i tha gjë, po të shoqt, nuk mundi të mos ia thotë.

— Moj grua, — ia bëri Gaqi një mëngjez, — mos më bëjnë veshët, apo kemi një misrok në mëhallë?!...

Femra bëri ca naze e sikur u përtyp për pakë, por tuafi burrë q'e njihte të shoqen, para se të nisej për në pazar ku ishte opingar, mësoi historin e misrokut të Naumçes.

Ishte kohë pune atij dhjetori. Usta Gaqi e harroi misrokun dhe bile e pandehu, të nesërmet të Shën Vasilit, të tretur me shijë të

veçantë, me të lëpira të gishtrinjet e lyerje të mustaqevet e, pa fjalë, tër kjo mesele e lëngëzoi, e lëndoi edhe e fryri kundra mikut kërnac. Po mëngjezin e dytë të motit të ri, Gaqi mbeti thujse pa frymë. Pa misrokun e Naumçes majë avllisë tek ia kishte marrë këngës:

— Klluq-klluq-klluq!...

Opingari qëndroi dhe ndërsa po soditte shpendin, që m'at-në të murit dëgjoji zërin e Cilkës e cila po ia bënte: «— Misrok! Tuj-tuj-tuj...» Po misroku vetëm i hodhi një sy çpërfillës asaj dhe s'lëvizi. Ahere ajo rendi brënda shtëpisë e pas cazë u kthye me Naumçen. Gaqi dëgjoji tani të shoqin e Cilkës t'i drejtohet tujkës: «— Misrok!... Tuj-tuj-tuj!...». Si për çudi, misroku këtë herë, hiç s'priti po, prej avllisë këceu andeja. Ku t'a dish, mbase Naumçeja i hodhi ndonjë grusht misëri... Gaqi dëgjoji përsëri zërin e Cilkës:

— Ore burrë, s'më dëgjon mua ti, s'më dëgjon.

— Ç'të dëgjoj, moj?

— Shko merr gërshërët dhe preja krahët misrokut se do marrë çairet donjë ditë, dëgjove? E unë, s'kam ngeh të rri t'a ruaj de...

— Hë-moj lesh-gjata ime... Si moj, t'i pres krahët!...

— Pendët, ore, pendët e krahëvevet. Në mos të tëra, siç do qe mirë, dobarem ca pe tyre që të mos mundë të frytyllojë gjer në çati.

— Si moj ia prekam pendët?!...

Gaqi s'majti më vesh. Duke hikur mbë maja të këpucëvevet që të mos i ndjehej ecja, ia bëri me vehte:

«— Po di titizi si hahet misroku! Shkembeja ose ndonjë kokë deleje, a ndonjë mëlçi në mbarim të pazarit, po». Buzëqeshi me një mënyrë të çuditëshme dhe shpejtoi hapin për në dyqan.

Në fillim të motit të ri puna u rrallua dhe në dyqanet e tyre prej opingarësh e këpucbërësish, muhabeti ishte m'i madh nga tregtimi.

Gaqi kishte dy fqinjë dyqani të cilët ushtronin të njëjtën zejë dhe që të tre ishin me nam si tuafët e tuafëvevet të Korçës.

Dërgoi njërin nga çirakët edhe thirri të dy shokët të cilëvevet u porositi nga një kafe. Ata s'e kuptuan ovardhallëkun mëngjezor të mikut, se ndërsa Thomua priste me vështrimin ngjeshur në fytyrën plot shejtanllëk të Gaqit, Tiri pyeti bramp:

— Hair, o Gaqi, përse të urojmë?

Gaqi u-urdhëroi çirakëvevet të vinin në Zall të mbushnin stomnën me ujë me gjithqë njëri syresh posa e kishte sjellë, se ia bëri me një mënyrë kundrështimi:

— Po, usta Gaqi, unë posa e solla nga çezma këtë stomnë...

— E-o, mirë, — ia preu ustaj — s'e ditkam un'a? Ec e mbush gjene, apo do m'a bësh fjalën dy?

Çiraku kapi stomnën pa hapur më gojën e u çduk. Tjatri që ishte m'i sgjuar, kishte kuptuar qëllimin e ustajt e ishte defur.

Dhe kështu të mbetur vetë rrotull tryezës së punës e duke thithur kafënë me bujë buzësh, Gaqi u tregoi historin e misrokut dhe pllanin që kishte kurdisur rrugës, siç vinte për në dyqan atë mëngjez. Të tre ranë njëmendjeje t'ia përllajnë misrokun Naumçes, t'a venë në tavë e të ftojnë edhe Naumçen për drekë. Pastaj që të tre, qesh'e qeshnë sa u mëknë e bënë muhabet gjer u sos, pas ndonjë ore, i allavituri çirak i parë me stomnën me ujë të ftohët.

Dy ditët që vashduan, tek dilte nga shtëpia mëngjezit, Gaqi e pa misrokun majë avllisë edhe dëgjoji Naumçen t'a thëresë.

* * *

Korçën e kishte zaptuar një thëllim i fortë. Dy dit përpara Shën Jovanit ia filloi edhe një dëbor e mirë që binte pllaze-pllaze.

Naumçja kishte vendosur, kundra dëshirës së gruas, që misrokun mos e therrnin për Shën Naum, as për mot të ri po për Shën Jovan me që ky ishte shënjtë që hoxhaku i tij, kishte lutur den-baba-den. Cilka s'ia bëri fjalën dy burrit për këtë vendim po bëri plot naze kur i shoqi i tha:

— There, ti Cilkë misrokun, mua s'më bën zemra.

— Uh! ore burrë. There vetë, unë s'kam therur donj'herë misrok.

— Do m'a bësh këtë qef, Cilkë, për bes't do m'a bësh. E, si t'a therish e t'a gatitish si e di ti duarflorinjta ime, kam edhe një porosi tjtatër: të ftosh për drekë Gaqin, Thomon edhe Tirin me gjith gra.

Kjo zemëbardhësi e të shoqt e habiti pakëz Cilkën por edhe e krenojti thellërisht. Ajo u ishte fort e detyruar atyre miqve të ngushtë të të shoqt por sidomos gravet të tyre me të cilat ishte edhe shoqe çupërie. Andaj përveshi mëngët, mpreu një hanxharkë edhe tha:

— Naumçe m'a bëre qefin si s'e pandehnja. Shko m'a sill misrokun këtu n'ashef.

S'ishte gdhirë akoma, po këtu-atje xheku filloi të dëgjohet kënga e ndonjë këndezi. Naumçja hapi derën të dalë. Një mori pllazesh dëbore hynë n'ashef. Ay e shtyri përsëri. Vajti mori fenerin, e ndezi dhe si hodhi mbi kokë një pallto të trashë shkoi nga qymezi i misrokut i cili bëri një bujë dreqi me përpëlitjet dhe me erën e krahëvet i kishte shojtur dritën. Kur ardhi pranë portës i ra me shqelmë edhe i thiri gruas:

— Cilkë, hape derën!

Gruaja ia çeli. Naumçja ishte i mbuluar me dëborë. Si hyri brënda ay me gjith gjeldetin, ajo i mori nga dora fenerin e shuar edhe iu lut të presë pak. Gruaja u çduk për një minutë e u kthye me një litarkë të shkurtë. I tha akoma të shoqt duke i marrë pallton nga koka:

— Vere përdhë atë misrokun sa t'ia lidh këmbët, Naumçe. — Lëshoi pallton në një kënd t'ashefit passi e shkundi me kujdes pastaj ardhi i lidhi këmbët misrokut, e si ia lidhi, ia shkeli me këmbën e saj të djathtë. Misrokun mend çmëndej. Nuamçes mend i binte të fikët, po ay bënte ç'i urdhëronte e shoqja. — «Ndehja krahët njëri mbi tjatin, tashi. Hë ashtu! Ajo vu këmbën e mëngjër mbë krahë të shpendit i cili ndënë peshë të gruas më s'lëviste dot». — «Me që s'më ndihmon dot, më mirë ec m'at-anë, burrë», i tha akoma me një si çpërfillje të paqëllimtë bashkëshortit. Ay s'bëri naze. Tek dilte e pa të shoqen të kapë hanxharkën që kishte vendosur afër saja përdhë, edhe dëgjoji zërin e mbytur të misrokut...

Cilka luftoi me shpendin e therur për një dy minuta. Ia plasi kokën me një copë lapucerë të gushës në një tavë balti, ia preu gjeldetit këmbët e i vuri në të njëjtën tavë pastaj i thiri të shoqt:

— Naumçe, ajde tashi...

Burri ardhi posi një kalama me dhembje barku.

— Do t'a le këtu pranë penxheres për një dy sahat e si të valojë ujët në gjymn e madh do t'i futem punës. Kam ndërmend t'a pjek në tepsin e thellë.

— E di vetë ti Cilkë. — Ia bëri ay si i trimëruar tani. I hoqi femrës së tija një të puthur në qafë tek ajo vendoste gjeldetin afër dritares.

— Uh, e ti Naumçe!... — ia bëri ajo si një mack e përkëdhelur. Edhe shtoi: — Trahani do jetë gati. Rri të hamë mëngjezin tashi.

Si ia thanë trahanit pinë edhe nga një kafe e gjene e shoqja urdhëroi:

— Naumçe, merr atë kokën edhe ato këmbët të misrokut edhe shko i hidh në teneqen e plehravet.

— Do jet mbuluar me dëborë, do jet. — Tha ay me mërzitje po i mori edhe shkoi.

Teneqen e mbanin andej afër qyvezit të tujkës. Dëborë vashdonte të bjerë, po dita kishte sbardhëllyer. Tek po pastronte kapakun e teneqesë nga dëborë q'e mbulonte, Naumçeja mbeti si i shastisur nga ç'i dëgjuan veshët. Në rrugë na filloi një serenatë e çudiçme:

— Klluuq-klluuq-klluuq!...

I habitur në kulm kundraxhiu mbajti vesh e mbajti edhe frymën. Po shpejt mësoi se ato të klluuqura nuk ishin as miskash as misrokësh. U mundua të marrë vesh në mos qe ndonjë lojë kalamanësh por zërat që vashdoi të dëgjojë linin të kuptohej se s'qe ashtu. Priti pak passi e mblodi vehten e filloi të buzëqeshë, të tundë kokën e të mbushë tulin se po të mos e kishin therur misrokun atë mëngjez. Tjetër kush do t'a kishte gllabëruar. E shoqja kishte të drejtë. Po njëherësh filloi t'ia bëjë edhe ay, duke kënduar sa më ngushtë muni ish misroku i tij:

— Klluuq-klluuq-klluuq!...

Një nga zërat në rrugë ia bëri, me gjithqë mengadal:

— Na dëgjo, ore, na dëgjo. E prite tashi kur të flytyrojë mbi avllit...

Naumçes iu duk si një zë i njohur, po n'at çast befasie. nuk i shkoi dot ndërmend se i kujt. Ia bëri përsëri: — Klluuq-klluuq-klluuq!...

E përgjigja i ardhë e xhallahishme se që të tre ata që përtej murit përdorë tërë mjeshtërin e tyre në të përngjarët të zërit misrokor.

Naumçeja mendoi: «T'u dal me ndojë dru birbovet që paskan ardhur për të vjedhur apo t'u thërres sikterisjen së këtejmi». Njëherësh vu re se kishte në dorën e mëngjër kokën edhe këmbët e misrokut. Qeshi e qeshi pa zë e pastaj ia mori këngës së misrokut dhe ndër-sa ata të rrugës vashdonin serenatën e tyre me këmbëngulje, Naumçeja u flaku që këtej avllisë kokën edhe këmbët e tujkës.

Një herësh, si një pe i këputur, serenata në rrugë mbaroi dhe me të mbajtur vesh Naumçeja kuptoi se qelbakët që kishin ardhur t'i rrëmbejn misrokun, ranë në thesin e shejtanllëkut të tyre duke ua dhënë këmbëvet mbë dëborën e thellë pors i kunadhe me çargun për bishti.

Immaginificazione idiomatica albanese

di Angela Cirrincione

(continuazione del nr. 1-2 anno 1965)

— E —

Erë-a, aria, odore, vento; sentore, traccia: **me marrë erë**, (prendere odore), odorare, fiutare; **u bâ erë**, si fece vento, fuggì come il vento, veloce; **me rá n'erë**, avere sentore, intuire; **s'merr erë nga ajo punë**, non capisce niente di quella cosa; **qeni rá n'erë**, il cane è sulle tracce.

— F —

Falë(me), donare, regalare, perdonare. Al passivo **me u falë** significa: dedicarsi, salutare, pregare, riverire o addirittura venerare, adorare (essendo il significato originario quello di prestare omaggio, nel senso antico di far dono della propria persona); **gjaku falet, por nderi jo**, il sangue si perdona, ma l'onore no; **të falem nderës**, ti ringrazio del favore; **të falem nderit**, ti ringrazio dell'onore; **falem-minderës**, grazie; **të falem, o Perendí**, ti adoro, o Dio! Continuando il significato di salutare e come azione conseguente al saluto, assume il significato di tramontare, prendere congedo: **hâna, dielli po falet**, la luna, il sole sta per tramontare.

Faqe-ja, volto, faccia; aspetto, apparenza. In unione al nome **njerí**, come **faqe njeriu** significa generazione, ossia periodo della vita d'un uomo e anche secolo; **njerí dý faqesh** o **me dý faqe**, uomo a due facce, ipocrita; **si mësalla me dý faqe**, come il tovagliolo a due facce, ipocrita; **faqja e zezë**, svergognato; **faqja e bardhë**, onorato; **me faqe të bardhë!** bene! **me faqe të zezë!** male! **s'ká sý e faqe**, non ha occhi e faccia, si vergogna (cfr. sic. nu n'avi facci di cumpariri, non ha coraggio di presentarsi, si vergogna); **me marrë faqe**, prendere coraggio.

Farë-a, seme, semenza; specie, sorta, razza, tribù: **me qitë fare**, distruggere, sterminare; **me dalë fare**, andare in rovina, estinguersi di una famiglia; **kush ká arën, nuk ká farën e kush ká farën, nuk ká arën**, chi ha il campo non ha semenza, chi ha la semenza non ha il campo, cioè chi ha una cosa non ne ha un'altra, non si può avere tutto in questa vita, corrisponde all'altro prov. **kush ká miellin, s'ká thesin, kush ká thesin, s'ká miellin**, chi ha la farina non ha il sacco, chi ha il sacco non ha la farina; **âsht prej farës së mirë**, è di buona razza; **nji fare njeriu**, un tale.

Fat-i, fato, destino; fortuna; consorte: **fati fati edhè te shtrati**, la fortuna anche a letto, chi nasce fortunato, continua ad esserlo; **për fat të keq**, disgraziatamente; **për fat të mirë**, fortunatamente; **fat-mirë**, fortunato; **fat-keq**, sfortunato; col suffisso **-os**, assume il significato di eroe, atleta, campione, **fat-os**; col suffisso verbale **-ue**, **fatue** = augurare; **s'ká vù kurr fat në vedi**, non si è mai sposato; **ky ásht fati i êm**, questi è il mio consorte; **i ká dalë fati**, ha trovato fidanzato o fidanzata; **i u thye fati**, il fidanzamento andò in fumo.

Fé-ja, fede, credenza, religione; animo, indole; specie, modo, segno, caparra di matrimonio, anello nuziale: **me dalë feje**, rinnegare la religione, uscire dalla retta via; **i pá fé**, ateo; **fet-ar**, credente, religioso; **ásht fé në vedi**, non è socievole, è misantropo; **feja e tij ásht loja**, la sua passione è il gioco; **feja e tij ásht parja**, crede solo nel danaro, il suo fine è il danaro; **për fé të Krishtit**, in verità; **me fé të Krishtit**, ottimamente. Lo troviamo in figura metonomica come causa per effetto: **e ké bâ me fé** o **me fé të gjallë**, lo hai fatto con amore, con fiducia di riuscire e sei riuscito ottimamente; **me i a luejtë fén**, (lett. mettere tutto l'animo, lo zelo in una cosa) fare una cosa a puntino; **mos báj fé kujdesi**, non darti alcuna specie di cura, non preoccuparti; **s'ká në fé të tij**, non c'è uno di tale specie, simile; **unë i a dij fén**, gli conosco l'animo, cioè lo conosco bene; **s'bâhet në ketë fé**, non si può andare avanti in questo modo; **me dá** o **me pré fén**, fissare la data del matrimonio.

Ferrë-a, spina; **m'ásht bâ ferrë**, mi si è fatto spina, mi è diventato insopportabile; **e kam gjithmonë ferrë ndër këmbë**, l'ho sempre fra i piedi, mi dà fastidio; **nuk i hyni ferrë në këmbë**, non gli entrò spina nel piede, non ebbe alcun fastidio. Ancora in senso figurato acquista un significato di rovina, desolazione, pianto, distruzione, come si può dedurre dall'imprecazione popolare: **t'u mbylltë dera me ferrë!** Che ti si chiuda la porta con lo spino, che tu possa andare in rovina, essere colpito da una grave sciagura! Che ti possano morire tutti i maschi della famiglia! Pare che questo significato derivi dall'antico uso di mettere alla porta della casa degli spini, quando la famiglia era colpita da grave lutto, come la morte del capo di famiglia. **I bâhet ferra Brahim**, gli diventa lo spino Brahim (si dice di uno ossessionato e sospettoso). L'Albanese spiega questo modo di dire così: un tale, essendo perseguitato da un certo Brahim, una volta, rimasto attaccato agli spini d'una siepe, ebbe l'impressione di essere stato preso dal suo persecutore (così ho apreso dalla viva voce del prof. K. Gurakuqi).

Fjalë-a, parola, discorso; promessa: **fjalë e vjetër** o **e moçme** o **e urtë**, proverbio, sentenza; **fjalë e dhânun**, parola data, promessa; **fjalë kote**, parole inutili; **fjalë e grosh**, parole ben ponderate; **fjalë pá krypë**, discorso insulso; **pá fjalë**, indubbiamente, senz'altro; **i pá fjalë**, taciturno; **ásht fjalë-madh**, di grosse parole, enfatico, ampolloso, esagerato; **fjalë shum e punë aspak**, molte parole e niente fatti, molto fumo e niente arrosto; **s'ká fjalë se...** non vi è dubbio che...; **ásht hapë fjala**, si è divulgata la notizia; **doli fjala se...** si sparse la voce che... **fjalë e foli**, così sentenziò; **bjen fjala o fjala vjen**, per esempio; **jemi të nijj fjale**, siamo d'accordo, della stessa idea; **doli fjale**, mancò alla promessa; **e hângri fjalën**, venne meno alla

LUIGJI Me pushue? Po si? Po ku?

RINA Këtu në shtëpi t'onë. Unë e Kostantini të duem si vëllá. Në gjendje të mirë, shyqyr Zotit, jemi. Tërhiqu nga politika e fillò një jetë të ré këtu te na.

LUIGJI Thae parë se më njeft... Po si mendon, moj Rinë, se unë kam zëmër aqë të ligë sa me qitë mbas shpinet çashtjen tue u dá m'a-nesh? Mendon se áshjt punë e bukur t'a mbylli jetën me një humbje politike si ajo qi pësuem e me një arratisje nga rrethi i shokve t'idealit si ai qi ti më këshillon? Do me thanë se nuk më njifke e nuk m'a doke të mirën si thue. Ç'më duhet jeta kur të koritem?

RINA Më fal se ndoshta të fola me guxim të tepruem. Por, ti e din mirfilli, ato fjalë dolen nga fundi i një shpirti qi të don. Për mue, i a ké hÿ një valles ku ké me sharrue. Këtë e kam thânë edhe má përpara, kur nxëjshim bashkë n'Universitet të Napullit: ti shkenca natyrore, unë matematikë...

LUIGJI Prandej nuk t'idhnohem, Rinë, pse këto nxitje m'i ké përsëritë njiqind e njimijë herë. Tjetër veshtrim i jep jetës ti, lum mikja, krejt tjetër i jap unë. Nuk mund të ndrroj... tash në pleqni...

RINA Ti nuk jé plakë aspak. E dishmon kryeneçsija e jote. Ké mbetë kryeneçë si ishe në riní e njerí me teka: tekanjòz! Njiqind spatë me i rá, asnji ashkël nuk i hiqet idés fikse, qi t'a hangri shpirtin e po t'a rrenon jetën. Jeta áshjt gjá e vlerëshme, Luigj; shum e vlerëshme: áshjt mëkat m'e rrenue kot për një tráll a për një ándërr të parealizueshme... Animirë, e kuptoj qi s'mundesh me ndëjë pa u përpjekë për vend t'and. Të ka hÿ për palc kjo lakmí. Por sèpaku tërhiqu për do kohë m'ánesh me pushue! Të dhânunit e tepruem me të cilin ti i ndjek këto punë, heret a vonë, ka me të dâmtue në shëndet e ka me të shkurtue jetën...

LUIGJI Këto fjalë, moj shoqe e vjetër e eme, qi më ké ndjekë ndër hapa të parë të përpjekjes për liri e për lumni të Shqipnis, — qyshë në Shë Mitër, a t'ë kujtohet?, kur kuvendojshem me babën t'and, burrë arbresh plot entuzjazëm qi më trimnonte m'u orvatë për rilindjen e atdheut; — këto fjalë, prap po të tham, më bindin, Rinë, se nuk më ké kuptue ashtu si duhet; s'ké hÿ në shpirt t'em, sadoqi njifemi tash má se njizetepesë vjet. Ti mendon se unë jam trashaman në shqise e në ndije, se nuk dij t'a shijoj jetën në të gjitha shfaqjet e bukurís me të cilat ajo paraqitet... A kujton se nuk m'i kande qetín e kënaqjet shtëpijake? Ase nuk më pëlqen atmosfera e ámbël e një banese së kandëshme si kjo? (*Shênjon sendet qi e rrethojnë*). Unë kam et davaritjeje... et miqsije... jam i rreshkun për dashuni! Ku e merr me jetue në një shtëpi si kjo, me gjind të njerzishëm e shpirt-mirë si jeni ti e Kostantini, në një vend të

qytetnuem... të lir... gazmuer?... Shka kishem me dhânë për të jetue në shtëpi t'eme në Shkodër afër nânës, qi përhera kam dishrue e më ka dishrue... m'e çue jetën pa trazime... tue u marrë me punë të qeta... — unë, për shembull, kam lé me prirje arsimitari... — me shkruie vjerrsha mâ fort për qejfi t'em se të tjervet. Por shtëpija e s'em-âmë âsht në një vend qi turbullohet tash e parë, një vend përhera në rrezik, përhera në duer mizore. Ndryshon veç emni i tyranís, sepse herë âsht e huej herë âsht vendase. Nuk të lânë me marrë frymë qetisht... pa të shnjzue, pa të shtërngue me u rá mohit ndiesíve mâ të shêjta e me i u shtrúe rrebeve të prapta të njerzvet qi kanë dhunën për mjeshtrí sundimi e një shkrim shtësnuer andjesh t'ulta si qellim jete. Ti e gëzon kët shtëpi, kët qetësi, dashunin e t'yt-shoq, prodhimin e punës së ndershëme t'anden e të tijen pse disa shpirtmëdhej n'Italí flijuen veten me u a sigurue tý e tjervet kët mirqênje. Ata i a kanë sjellë shpinën me vetmohim të mirave, për të krijue për jue shartet e një jetese së qetë në liri e në gëzim të drejtave njerzore e qytetare. Ti këtë e kupton?

RINA (*e prekun*) Si jo? E kuptoj fare mirë.

LUIGJI (*e mundështon tue buzëqeshun*) E atëherë, prá, mos mendò se na atdheadashët u biejmë mohit të mirave qi dhuron jeta pse jemi disi të cokatun në kokë e shise-trashë e se nuk u a njofim atyne vlerën por bindu se kemi pranue vullnetarisht një detyrë të randë e duem t'i rrijmë në të pa i u shtëmangë. Të randë sa të thuesh, por qi ka edhe ajo hov hov kënaqjet e veta... Me pá një gjinde tue u zgjue mbas sa shekujsh letargjije... me i a këputë verigat një popullit... A por nuk të mbushet ende mendja se kanë vlerë kënaqje të tilla?

RINA (*e thyeme*) Jé njeri i madh, shkurt e mbarò! Bota ka pak njerz si ti!

LUIGJI Nuk fillon e nuk mbaron në mue atdhetarizmi, Rinë e dashun, as në Shqipni as në botë. Trimi i mirë me shokë shum... Nuk mungojnë trimat e mirë ndër né, por Shqipnija ka nevojë për shum bij të vjefshëm... për m'u vù n'udhë të mbarë.

RINA Uroj qi të kët një mori Gurakuqash. (*Në të qeshun*) Por, atëherë, do t'ishte tepër e vogël për njerz kaq të mëdhej... (*Çohet*) Tash më fal: kam një punë me krye: do të shkoj me dhânë një mësim privat...

LUIGJI Po dalim bashkë.

RINA Jo, jo: ti rri. Ka kush të bân shoqni... edhe mâ mirë se unë! E merr me mend se kush?

(*Shkon te dera e mbajtë, shtjen kryet mbrëndë e thrret: « Serafinë! »*)

LUIGJI (*me habi të madhe e disi i shqetësue*) Si? Si?

SERAFINA (*hÿn e shef Gurakuqin; merr m'u flakrue kah ai si të donte m'e rrokë ngrykas, por me një përpjekje të fortë vullneti e ndalon veten, tue u zbë mâ parë e mandej tue u kuqë*) Luigj, mirë se erdhe!

LUIGJI (*i merret goja*) Gjithëshka... ki-kishem me-mendue, Serafinë, por jo se të gjëj kë-këtu?

RINA (*Luigjit*) Asht tash mâ se një muej te na. Ika... Lamtumirë! Po shkoj e po vÿj. Nuk vonohem. Mos luej vendit, ti Luigj. Tash qi

e xûne udhën e shtëpís s'onë edhe erdhe, nuk të lëshojmë kollaj me shkue! (*Del kah e mbajta*).

LUIGJI Vërtë nuk pritshem me të pá sot këtu!

SERAFINA (*me sherrí t'âmbël*) E po të vjen keq?

LUIGJI (*i ep përgjegje me një shikim në të cilin dashuni ja mbytet në trishtim*) Pse flet kështu?

SERAFINA (*e merr për dore edhe ulë afër vetes në divan*) Të kam pritë e të kam pritë. E ti... kurrkund! Pse vonove kaq tepër me ardhë? Ti argtohesh kur unë vuej. Gjithmonë më ké mundue...

LUIGJI Pikë s'pari s'e kam dijtë se jé në Bari e mandej jam këné e jam vërtë i xânun. Pak a shumë ké marrë vesht shka na ka ndodhë... Të ka kallzue Kostantini?

SERAFINA S'kam pasë nevojë me i marrë vesht ngjarjet prej Kostantinit, pse tÿ e punët të tueja i kam ndjekë gjithmonë me má të madhen vemendje. Ti na ké qitë në harresë, por na jo...

LUIGJI Serafinë!

SERAFINA A shef se ké harrue gjithëshka? Pse Serafinë? Dikúr m'a pate njëte Naçe. Pse nuk më thrrret « Naçe » si atëherë?

LUIGJI Kanë kalue shumë vjet...

SERAFINA Pikënisht njimbëdhetë vjet: me 1914...

LUIGJI Atëherë ti ishe shumë e ré, Naçe!

SERAFINA Po biejshe në njizetepesë vjetat. Sot kam dhetë a njëmbëdhetë má tepër, por zëmra më ka mbetë e njomë. Asht ndalë aty n'at stinë e me të aty ka qindrue edhe ndiesija e eme për tÿ. Ndoshta të duket se jam plakë?

LUIGJI Mos e fol at fjalë. Ké marrë hije zojash pa e bjerrë aspak hijeshín e njomë të vajzënis. Sÿt të ndrisin plot gjallëni si atëherë...

SERAFINA (*rreh gjoksin*) Sepse edhe këtu ndiesít kanë mbetë si në moshë fmijnore kur ishem vajzuke me bishteca e të njofta s'pari në shtëpi t'em'eti në Shën Mitër. Mban mend? më tregojshe historín e Skanderbegut. Ndër ândrra të shifshem tÿ në vraç zjarmuer. Për mue Skanderbegu kishte dukën t'ande.

LUIGJI Ândrra vajzash qi zhdavariten shpejt. Sot kur shikohem në pasqyrë më duket vetja Don Kishot...

SERAFINA Qyshë të vogël m'a ké mësue shqipen e në Napull më dhae me kopjue vjerrshat të tueja. Unë jam ushqye me dritën e shpirtit t'and. Çdo gjá tjetër, atëherë e mbrapa, qi s'kishte lidhje me tÿ, më gitej e pa krypë. M'a ké rëmbye shpirtin qyshë në moshën má të blerët, më ké njimtue... Pa dashtë, e dij. Kur u kujtove, bâne ç'mos me më shporrë teje. Tepër vonë: unë kishem xânë marak. E ti ike e më lae: ike e u zhduke... Mizuer!

LUIGJI E shof, Naçe, se don me më mundue me fjalë! Të kesh dhimbë për një dashamirë t'andin qi fati ka dermue me një shplakë të papritun e të pameritueme.

SERAFINA (*tue u rrasë në krah të tij me llasë vashnore*) Due me të ndihmue, jo me t'a lëndue shpirtin. Sot e mbrapa due me të ndjë afër: deshte s'deshte, ké me më pasë ngjat vedit.

LUIGJI Do të kishte fatbardhësi má të madhe për mue? Por, ti e din, unë s'jam i vetvetes. I a kam kushtue jetën një qellimi qi ti njef má mirë se askush edhe e dij se e çmon.

SERAFINA Unë të shof gjithmonë të rrethuem me dritën e atij qelimi të naltë.

LUIGJI Po atëherë ti e kupton fare mirë qi një lidhje dashunore do të turbullonte ndiesit qi e ushqejnë at qellim. Ja Shqipnija ja ti. A mban mend kur me 1906 mbyta në vetvete poezin? nusen e mreku llueshme qi adhurojshem... sá...

SERAFINA Sá...?

LUIGJI ... sa tý! Fundi i shpirtit t'em u bâ vorr, vorri i poezís, i vashës hyjnore, prej së cilës u lirova... — e më pikoj zêmra gjak prej pikllimit... — u shporra për mos me u habitë... m'u përqendru me të gjitha fuqít e mija në përpjekje për rilindje t'atdheut. Mâ mirë se askush ti e kupton tragjedín t'eme. Ika prej teje me 1914 nga friga. Ndrydha në shpírt ndiesín qi më dejte. Kam luftue, Nage, me vetvete. Këto janë luftimet qi dermojnë mâ tepër se ato me anmiq. Për pak atëherë nga shkaku i yt kjeçë tue u ndalë në Napull mësá detyra atdhetare lypte pranin t'eme në Shqipni. Të kam drashtë e të drue prap...

SERAFINA Këtu gabon. Gabon pse s'ké kuptue ç'lloj dashunije ásht kjo e emja. Unë nuk lypi qi ti të flijoish për mue ndiesít mâ të shtrëjta të tueja. Unë nuk të këshilloj, si bân Rina, me u tërhjekë në një skâj jashta luftës ideale për me endë një jetë pa lavdí. Mos e thashtë Zoti! S'mund e mendoj një Gurakuq qi jeton si... im kunat Kostantini, për shembull! Gurakuqi nuk do t'ishte idhulli i em po të hiqte dorë nga ideali qi rroku porsa mori mend e shqise... Vajzuke e njome, po e përsëris, të shifshem ándërr e zhgjándërr si kreshnik prrallzuer. Ethet e idealit qi t'a ndezshin flakë shpirtin m'u ngjiten edhe mue. Sa isha vajzë, u mahnita mbas fatosit qi donte t'u farkonte Shqiptarvet një fat të lum e t'u dhuronte një atdhë të lír. Kur u rrita, xûna marak në burrin me vullnet të hekurt qi dallohej në shêj ndër tjerë për guximtarí qellimesh e kuptova se nuk do t'a ndiejshem jetën t'eme të plotsueme veçse në krah t'and, të luftarit zëmer-madh vaditë në shakulluer të duhinave të rrehta. Më joshte rrahja e ernave rrembyese të këthesavet historike... Me tý... në krah t'and... në ngadhnjime e në humbje, burr-neshë edhe unë ndër rreziqe... njome, jestek i butë ndër pushime...

LUIGJI (*i prekun*) Jé brumë kreshnikësh, stërmbesë e bashkëlufartvet të Skanderbegut qi mreku lluen botën me trimní të tyne... Nuk guditëm.

SERAFINA Me këtë lloj dashunije unë të due... me njikët ndiesí e cila nuk i a shafitë por i a shton flakimin idealit t'and... idealit qi synon shpërblimin e një kombi e nxjerrjen e tij prej territ mesjetar në dritën e qytetnimit mâ të lartë... Kështu të dashunoj! E të bân zêmra tashí me ikë prap larg meje tue drashtë se unë t'a fiku ase t'a ligështoj në zêmër at qellim qi ásht arsyeja e vetme e jetës s'ate? Fol.

LUIGJI (*mendueshëm si të flitke vetimeveti*) Prísat janë të dënuem m'u ngujue në vetëmi! Në të vërtetën s'kanë as miq as shokë, por ndjeka ase anmiq. Nuk munden me i a çilë zêmrën kurrkuj sepse, po kërkuen një shfrim gëzimi, rrethi mund t'a kuptonte porsi siguri ngadhnjimi e mund të mendonte se gëdhini dita e një çarmatosjeje vullnetesh; po u shpëtoi një fjalë dyshimi, kjo mund të shkaktojë

pasiguri e pështjellim. Prandej një pris domosdo do të vetmohet tue ndrydhë mendimet e ndiesit mâ të hovshme në heshtje. Duhet të ngujohet në vetmë sepse kjo e fuqison. Por kjo vetmë edhe lodhë... Ah sa freskon mundësija me i a hjekë drÿjt shpirtit... m'e lânë shpirtin me i derdhë lirisht shpresat e dyshimet... Ku e merr një pushim në një rreth ku mundesh me ditue çiltas ndiesit...

SERAFINA ... e me mbështetë kryet në një jestek të butë...

LUIGJI Kushedi? pushimi me vend e me kohë këndellë trupin e shpirtin... Po, me ndodhë e kundërta?

SERAFINA A dron mâ tepër veten t'ande apor mue? Po këtë i sigurtë për fuqin qindruese t'ande, e kë thanë në një vjerrshë të rinis s'ate « *Mjer'ai qi nuk qindron* », po të jesh i vendosun me durue, aspak nuk duhet të dyshojsh mbi cilsin e dashunís s'eme, e cila — po t'a tham e po t'a stërtham — s'ka si të ligështon sepse, po pau një Luigj të dobsuem n'ideal, do t'u shkimte si kandili pa voj.

LUIGJI (*me butësi*) Por atëherë veç, kur t'i shkrijmë e t'i bâjmë një jetët t'ona, unë mësohem keq, jes kryekëput pa mproje në rrymbë të valës dashunore e cila, — jena njerz mishit e gjakut! — mundet m'u paksue në tý... Kur të turbullohem në mende e të varrohem keqas në zëmër, shkasi për ideal s'ka mâ hov!

SERAFINA (*me zâ të prëm*) Kurr s'ka me ndodhë ajo gjâ!

LUIGJI ... ase mundet qi fatbardhësija bân me bÿjtë në mue një ndiesí egoiste qi më shtÿn m'u dhënë vetëm e vetëm mbas teje, tue qitë në rend të dytë të gjitha sendet tjera, në to edhe çashtjen e Shqipnis...

SERAFINA (*brofë në kambë e flet me zâ të ngashëruem*) Ah, njeri besë-pakët! Qyshë se kë vrá në vetvete poetin e jé marrë me politikë, t'u kanë verbue sÿt e mendes. E kuptoj qi në politikë, tue ngjeshë brumin njerzuer plot dobsina e pabesina, jé mësure me u bâ vesvese për gjithëka. Shef pritën e trathtin edhe në gjinde qi japin shpirtin për tý. Vërtë qi njerzit janë të prirun me bâ mâ shum keq se mirë dhe me dâmtue mâ shum të mirin se të keqin, por një burrë me përvojë t'ande duhet t'a njofti tingullin e së vërtetës në zâ. Dashunija e eme për tý qyshë se ishem fëmij qet flakë e shkëndija. Æsht pjekë në mish t'em nëpër flakë t'idealit t'and, qi Æsht bâ shpirt i shpirtit t'em. Vlon në gjak tash njizet vjet... (*Shetitë rrebullueshëm nëpër kthinë*).

LUIGJI (*matet tue folë ngurrueshëm*) Po... mbrënda këtyne vjetve... ti... jé martue... Kjo don me thënë se...

SERAFINA (*tue u sjellë me hov kah Gurakuqi*) Këtu të deshta. Bâne mirë qi e preke këtë pikë. (*Me theksim të fortë në zâ*). Po, jam martue me ndjet të prëm qi me hapë një humbnerë në mes nesh. Rina më nxitte. Ti shkove me 1914 pa më thënë gjâ. E, prâ, ndiesin t'eme e njifshe. M'a lexojsh në ball, m'a hetojsh në dridhje të shtatit, e ndiejshe n'afsh të buzve të mija... Me fjalë nuk pata kurr guximin me t'a rrëfye, por u kujtojshem se ti kuptojsh mirfillí shka m'a digjte shpirtin. Shtijshe veshët në lesh. E ike pa më thënë asnjë gjysmë fjale. Qindrova sa qindrova, por tekembramja, i u shtrova dishirit të Rinës e u fejova. Mâ mirë të thom lëjova Rinën qi të më fejonte...

LUIGJI Me një burrë zotni, zëmërbardhë e me sjellje shembullore... më kanë thënë!...

SERAFINA Po, i shkreti! I a dojshem të mirën, por... si të spjegohem?... nuk e dojshem mirë. E çmojshem, por pranë tij nuk ndiejshem në vete asnjë shëj thekuniye dashunore. Mbas një moji qi vum kunorë, u pendova për martesë të bëme. Sa herë më tundoj i mallkuemi m'e lënë burrin e me u këthye në gjini. Por jam arbreshe. Ti e din si na kanë rritë prindët e si na e kanë shti për palc përttimin e nderit. Edhe kur mendja bindej, nuk ndëgjonte zëmra me dalë hullijet tue shnerzue veten e prindët e tue mjerue burrin e pafaj. Mendimi i yt nuk më lënte të qetë, as kur u hap fjala se të kishin pushkatue Malazezët. Thojshem: «Edhe në mos kjoftë më gjallë, e kam për detyrë me i ndëjë besnike kujtimit të tij». (*Ndalet e fshân*) Kur më fali Zoti një djalë, nuk dij shka më shtÿni me i thënë burrit: «Po i a njesim emnin Luigj!» Ai krah-thati donte t'a quente n'emen t'et e kishte të drejtë, por çdo dishir i em ishte urdhun për të: më kënaqte në çdo trill. Sjelljet e tija plot mirsi bujare m'i shtojshin të brëmet e zëmërës. Tue e përkëdhelë djalin në prëhen e tue e thirrë «Luigj» ndiejshem se dashuniya e thjeshtë për të turbullohej tue u përzí me një ndiesí të fajshëme mëkati. E Zoti më ndeshkoi. Djali më diq pa mbushë vjetin. (*Qán me lot të heshtueshëm*).

LUIGJI Lëne: mos i a përtrij vetes trishtimet e kalueme.

SERAFINA Më dermojnë këto kujtime, por do të vijoje. Due me të bindë se në martesë nuk gjeta shërimin nga helmi qi thitha në fminí tue jetue pranë teje. Kij mirsin e ndëgjoje deri në fund kët historí. Me 1920 kur erdhe nga Parisi në Napull, unë me burrin banojshem në Romë. Mora vesht ardhjen t'ande. Ndiesít m'u çuen peshë. Luftojshin rrebtas mbrënda meje nderi me dashunin. U orvata me qindrue. Mblodha të gjitha fuqit e mija. Rrijshe me orë në kishë tue lutë Zotin me më largue tundimin, me m'a tretë kujtimin t'and. Por kot. Dishiri me të pá, me të rrëfye vuejtjet qi më shkaktonte largesa e jote, ndjeti qi me u bashkue me tý, po të më pranojshe, thyen e rroposen çdo ndiesí a mendim të mbarë e t'urtë. Pa lajmue burrin, mora një tren për Napull. e nisun fill te ti, e vendosun me t'a xanë derën. Udhës pata kohë m'e pleqne má thellë punën t'eme. Kuptova turpin e asaj sjelljeje. Burri i em nuk e meritonte at shnerzim. Mbërrijta në Napull edhe, pa dalë prej stacionit, prita nisjen e të parit tren për Romë. Këtheva në shtëpí. Burri nuk u kujtue. Ai vdiq mbas pak kohe nga një sëmundje e randë qi u shfaq papritë. E jam e kënaqun qi nuk i a zezova jetën me një sjellje të pandershëme. Sa lëngoi në klinikë, i erdha rreth si një vëllaut. Ai kurr nuk u kujtue për luftat qi m'a tronditen shpirtin gjatë bashkëjetesës s'onë. Më gjikonte si grue të përsosun, por me natyrë pak si të ftofët. Kujdesi i em gjatë smundjes e bindí se unë e dashunojshem thellësisht pa kënë e zoja me kapërcye prujtunin t'eme të natyrëshme me një shfaqje të hapun të ndiesive të mija. Me kët mendim vdiq orziu. Tashti Rina don qi të martohem prap...

LUIGJI E ti?

SERAFINA (*vjen e ulet pranë tij, i a shtrëngon të dyja duert e, tue*

e shikue drejt ndër sý, thotë:.) Po; veçse me tý... Tash jam e lirë-shme edhe dashunín t'eme për tý mund e shpalli botnisht, pa mëkat e pa kori... Para Zotit e para robit tham se jam e do të mbes e jotja, deshte s'deshte.

LUIGJI (përshpëritë dashunisht) Naçe...

SERAFINA (mbështetë kryet në krah të Luigjit) Jam e jotja, luftare pranë luftarit në poterë... jestek i butë në dit qetije... E këso here nuk të lëshoj...

LUIGJI (tue i a lëmue lehtë flokët) Pranija e jote, qe, në kët rrethânë turbulluese e shof se m'a njomson zëmren... më përtrín vullnetin... m'ep shkas të rí me i përballue luftimet e rrehta e kujdeset dërmuese qi më presin sa të dal prej këndej.

SERAFINA (me një të trandme gëzimi në trup e në zâ) Pse nuk më merr gjithëkund pranë teje sot e mbrapa? Kë me flakrue në luftime si luâ. Ndëgjô Naçen t'ande. Thuej po, thuej... (Ndëgjohej një tringullimë zili në rruginë kah dera në fund t'anës së djathët. Pak mbrapa kumbon zâni i të zotit të shtëpis).

KOSTANTINI (tue hý në kthinë nga rrugina) Sa mirë qi të kënka mbushë mendja me ardhë e me i pá Rinën e Serafinën. E paske qitë topin tekembramja.

LUIGJI Po ti për Serafinën nuk më kallzove se ishte në Bari!

KOSTANTINI Ajo vetë ka dashtë qi t'a marrish vesht papritmas tue ardhë këtu.

SERAFINA (ndreqë flokët me të dyja duert, e çon kah i kunati fytyrën plot dritë gëzimi) I ka ardhë mirë fort qi më ka gjetë te ti.

KOSTANTINI (tue veshtrve ngultas njânin e tjetrën) S'e vë në dyshim. Don me thânë se tash qi na e din shtëpín, ka me ardhë shpesh...

LUIGJI (shikon Serafinën) Po do të vîj, do të vîj, shpesh!

KOSTANTINI Po ti, Serafinë, a i ké qitë gjâ me pí Luigjit?

SERAFINA Kam harrue krejt. Jam marrë mendsh.

KOSTANTINI Duket se keni pasë bisedim t'interesantshëm. Por, tash, duhet të pín ndoj send.

(Serafina shkon e çilë raftin ku janë pijet e u vën trimave para nga një kupë vermouth).

LUIGJI Jë kënë edhe sonte në Kafe «Stoppani» me më kërkue?

KOSTANTINI Jo, por ndesha udhës Angjelinin e mora vesht se shpejt do të nisesh për Vjenë.

SERAFINA (E shqetësue) Do të nisesh?

LUIGJI Po, por do të këtëhem menjihërë. Jemi tue i vû bazat një bashkimi të përgjithëshëm. Sonte kam një takim me një randésí. Si të rregullohet puna këtu, do të piqem në Vjenë me Nolin.

KOSTANTINI Atëherë keni shpresë se mund të bâhet dishka...

LUIGJI Na do të punojmë, mandej suksezi i punës mëvaret nga shum faktorë qi s'janë në dorë t'onë.

KOSTANTINI S'kemi pasë deri tash rasën, Luigj, me ndëjë lirisht bashkë. Në «Stoppani» të kam gjetë përherë rrethue me shokë. A bân me të pyetë se si përfundoi kryengritja e qershorit të vjetshëm në një deshtim... më fal...

LUIGJI Jo, jo, thueje fjalën: i përgjegjë s'vertetës...

KOSTANTINI (Serafinës) E din sa sympathín e gëzon ndër Shqiptarë

Luigji? Rrijnë tue i a ndëgjue fjalën me nderim të madh. Vë roe, kur jam aty në shoqni me ta, se fjala e tij fashitë turbullimin e shpirtënvet. Besojnë ngultas n'atë qi thotë...

LUIGJI (*tue buzqeshë*) Po nuk i kam gënjye kurr!

KOSTANTINI Unë mâ parë se të gjithë t'a njofta zotsin në Shën Mitër e në Napull. Shum vjet kalueme bashkë në rini. Por asokohe spikatshe për vrrull mendimesh e për sqimtarí shprehjesh. Shkumbonte enthuzjajzmi në çdo nisjativë t'ande. Edhe mue, qi të njoj në themel, sot më bân përshtypje këthielltija me të cilën i kundron çashtjet e sigurimi qi difton ndër drejtime për të marrë. Ata shokë qi të rrethojnë ndiejnë si unë se vetëm ti jé në naltësi të detyrës së një udhëheqsi. Shqiptarë e Arbreshë kemi një ves të keq: ngurrojmë me i a njoftë eprorin mendore njâni tjetrit edhe kur ajo eprorí shkelqen sheshazi. Por tý shokët të njoftin si pris... E këta njerz qi ké me vete më duket se janë ajka e Shqipnis: të gjithë të shkolluem si të vjetrit ashtu të rijt... Prap po të pyes: si ndodhi qi një aradhje së tillë njerzish të zgjedhun e me përgatitje të plotë kulturore i muer puna në thue?

LUIGJI Shkon gjatë me t'a diftue imtisht fillesën e mbaresën e ndër-marrjes s'onë qeverritare. Besoj se arsyeja kryesore qindron në fakt se përgjithësisht masa e popullit është lirue nga zgjedha azjati-ke, por ka mbetë skllave e trashigimit shekulluer të saj. Tepër shumë paragjikime krahinore e fetare pengojnë në popull pâmjen e një interese së përbashkët. Shqipni don gjithëkushi por të sendërgjue-me mbas andjes së vet, mbas një andjeje qi njipërnjisohet me interesat e vogla vetiake, të klanit ase të një rrethi të ngushtë personash. Shqiptari dron idët e reja. Dyshon në kulturë. Pelqen traditën.

KOSTANTINI Po ti s'jé këne kurr kundra traditave...

LUIGJI Përkundrazi jam adhures i traditave të shëndoshta vërtë shqiptare. Thalbi i përvojës stërgjyshore duhet të përtrihet në frymë t'ideve të kohës së tashme. Shkurt: kam përshtypjen se populli në përgjithësi dresht kalimin e sundimit në duer të njerzvet qi nuk bájshin emna tradicjonalë krenësh por kishin vetëm merita kulturore. S'paku kështu më duket mue...

KOSTANTINI Atëherë ai popull s'don qytetnimin...

LUIGJI Populli s'ká faj. Fatkeqsít e parreshtuna historike e shtrënguen t'i presin ndrrimet me mosbesim. I u desht gjithmonë të hollojë mendin me zgjedhë ndër të këqija atë mâ të voglën. Gjatë shekujvet një stinë e mirë nuk lulzoi kurr për të. Sa herë qi u perpoq për një lehtësim të gjendjes së mjerë, rá keq e mâ keq. Erdhëm na në qeverri të përsjellun me enthuzjazmin e të rijvet, me miratimin e patrjotave qi popullit i dhuruen një atdhë. Po kush ishín në sy të popullit të rijt e patriotat? Njerz të shqetësuem qi dojshin ndri-me themelore në jetë të kombit. Populli nuk ndiente nevojën me dalë nga hullija e vjetër. Pamvarsija, për shumicën, kishte veshtrimin me pasë në krye Shqiptarin, jo të huejin; për kallam kusúr deshironte me qindrue në qyshke jetese mesjetare. Të rijvet dhe atdhetarvet intelektualë i a dronte hovin përtrís, mësá qi paris së vjetër të vendit i a dinte të rámit, i a njifte vetit e mira e të këqija. N'anë tjetër krenët tradicjonalë, të vaditun n'artin e sundi-

mit, dijnë të drejtpeshohen mjeshterisht ndër prirje të shëndoshta e të dobta të popullit pa i a prekun paragjikimet.

KOSTANTINI E kuptoj: i ngujuem ndër lugje malesh të pakapërcyeshme gjatë qindvjetave, populli mujt me ruejtë gjuhë e tradita dhe emnin shqiptar, por tue flijue rasat qi mujshin t'i a rrisin qytetnimin. Vetëm arsimi e vën në gjendje të kuptojë ku qindron e mira. Duhet kohë...

LUIGJI Këtu qindron tragjedija e jonë: koha nuk pret! Sot populli shqiptar, me deshtim të përpjekjes liberale t'onë, ka këthye mbra-pa. Na do t'a mëkambëshim n'udhë të përparimit shoqnuer, tue i a shpejtue arrijtjen në një plotësim të vetedijes kombtare. Historija nuk pret. Drue se përparimi shoqnuer, sot i penguem, në vend qi me ndjekë rythmin e një zhvillimi shkallë shkallë si e dojshim na, do të na futet mbrendë heret a vonë me turr, pështjellueshëm, tue vû në rrezik vetit qënësore të substances s'onë ethnike. Ahmarrjet e historis janë të rrehta kundra atyne qi i a përbuzin frymën...

KOSTANTINI Popullin e patët a s'e patët me vete?

LUIGJI Pjesa më e ndritun na ndiqte me entuzhazëm. Turmat për me na mbështetë prithshin me pá ç'drejtim do t'u epshim punve të vendit. Sigurisht i erdhi keq për deshtimin t'onë. Por nuk luejti gisht me mprojtë as personat t'ona as idén liberale qi na përfaqësojshim. Por... ndoshta unë e sipërvleftësoj rrolin qi mund të lunte populli. Nji tjetër ngjarje ndërkombtare i a ligështoi bazat rregjimit t'onë: rámja n'Anglí e qeverris së Macdonald-it edhe përhapja e nji atmosfere antidemokratike në mbarë Europën... Kjo e dha mundësi nji ushtrie së huej me ndërhy! Na ishim demokratë e demokracija na la pa përkrahsa.

KOSTANTINI Besa, edhe këtu n'Italí, gjasët janë qi demokracija s'e ka të gjatë...

LUIGJI Sidokjoftë na do të luftojmë për krijimin e nji shteti shqiptar të pamvarun e të renduem mbi parime barasije e drejtësije shoqnore, pa u ndikue nga rrymbat e reja qi po shpërthejnë hêm nga Lindja hêm nga Prendimi. Kanûni i vjetër i ynë nuk i njef asnji Shqiptarit privilegje: sejcili zog i Shqipës pëshon në kandar të vet 400 derhem. Na synojmë krijimin e nji Shqipnie ku sejcili t'a ndieje veten të siguruem ndër të drejta të veta.

KOSTANTINI Jë nji vigâ mende-ndritun e zëmër-bardhë!

LUIGJI S'jam tjetër, lum miku, veç nji njeri qi ásht ngarkue vullnetarisht me nji detyrë ndoshta mbinjerezore por qi ásht i vendosun ja m'e plotësue ja me thye kryet.

KOSTANTINI Ka me të ndihmue Zoti me i a dalë në skâj qellimeve bujare të tueja. A mban mend? Kur ishe student universitar në Napull u shprehshe po në kët mënyrë: «Ja do të bâjmë Shqipnín e pamvarun ja do të vdesim të gjithë». E me 1912 e ngrehe në Vlonë bashkë me Ismail Qemalin flâmurin e pamvarsís. Vetëm këtë me pasë bâ, mjaft ké bâ për Shqipnín e Shqiptarë. Punë e madhë-nueshme!

LUIGJI Atëherë përpjekja paraqitej me mâ pak vishtirsí. Kishim luftë me të huejin. Sot kemi luftë me Shqiptarë të verbuem nga paragjikime të trënta. Atëherë ishte e bukur vdekja për ball an-

miqvet të Shqipnís; sot jemi në rrezik se biejmë viktima të një dore vëllavrase. Do përlëshje mjaft të papëlqyeshme na presin. Kacafytje Shqiptarë me Shqiptarë. Kjo më lodhë shpirtnisht.

KOSTANTINI Kë nevojë me pushue për do kohë...

SERAFINA Atë i thaçë edhe unë!

LUIGJI Sa të mëkambet organizata e mergatës, due t'a ndjek këshillin t'uej.

SERAFINA (*Kostantinit*) E kam ftue me ardhë në Shën Mitër.

LUIGJI (*tue shikue ambëlsisht Serafinën*) Do të vij, do të vij. Në dashtë Zoti, verën do t'a kalojmë bashkë aty.

KOSTANTINI (*me dalldí*) T'a lumsha! Të njof si burrë fjalet. Jam i sigurtë se do t'a mbajsh premtimin.

RINA (*tue hý nga e djathta*) Sa mirë qi të gjeta. Mbasi ké ndëjë kaq gjatë, t'a fali tashti fajin qi na bâne me pritë dy muej vizitën t'ande. Po rri për darkë, ás?

LUIGJI (*tue u çue e tue shikue sahatin*) Sonte s'mundem...

RINA Nji çini po shtojmë. Me tý s'po bájme katikule. Jé i shtëpis...

LUIGJI S'mundem kurrsesi. Do të shkoj në Hótel «Cavour» m'u pá me do shokë e n'orën 9 kam një takim, qi s'mundem kurrsesi m'e shtëj.

SERAFINA Nesër mbrama, atëherë.

LUIGJI Pa tjetër.

SERAFINA M'ep besën?

LUIGJI (*tue qeshë*) Posi jo? T'ap besën shqiptare edhe arbreshe. (*Të gjithvet*) U falem nderës. Kam kalue këtu me jue disa orë vërtë të kandëshme. Më ka pushue shpirti. Kishem nevojë m'u gjetë në mes miqësh të vjetër. Thitha prap ernat mëngjesore të rinís, të Shën Mitrit, kur mësimet e De Radës m'a pajisshin shpirtin me flatra të gjalla. Erdha i lodhun e po dal me vullnet të përtrim... Lamtumirë!

KOSTANTINI Udha e mbarë. Nesër prej mbramjet vij e të marrë në Kafe «Stoppani» (*Dalin të gjithë m'e përsjellë, mandej mbas pak t'imtash këthejnë*).

RINA A më duket a dishka ka luejtë në mungesë t'eme?

KOSTANTINI Shka ka pasë me luejtë? Luigji i shkretë është i lodhun. Ka nevojë për pushim. Ndër shokë s'mundet m'u hapë lirisht. Dron se i ligështon tue u a rrëfye dyshimet dhe shqetësimin qi i shkakton vetedija e përgjegjësis së randë me të cilën ka ngarkue veten. E këtu te na gjën pak qetí...

RINA (*Serafinës*) A mujte me i folë haptas?

SERAFINA Po, i a çila zëmrën...

RINA Ai shka tha?

SERAFINA Më ka dhënë një gjymsë fjalë se vjen me kalue verën në Shë Mitër.

RINA Tërhiqet prej politikës?

SERAFINA (*disi padurueshëm*) Ajo e tija s'është politikë, është veprim patritotik. Nuk e njehë Shqipnín ende të lirueme. Deri sa mos t'a shofi të lirë e të lume, nuk tërhiqet!

RINA Atëherë má mirë mos të vijë në Shën Mitër.

SERAFINA (*gati si me egërcim*) E pse?

RINA Po e pat pranue me ardhë në Shën Mitër don me thënë se lidhet

me tý. E unë, lum motra, qi t'a due të mirën, nuk e shof t'arsyeshme lidhjen t'ande me një burrë të kapërthyer në punë të rrezikëshme. Æsht njeri, unë e kam njoftë para jush, për t'u adhurue por jo për t'u zgjedhë për shok jete. Nji familje krijohet në qetë, jo në poterë të duhinave shpartalluese.

SERAFINA (*qetisht por me një theksim vendosmenije në tingull të zânit*) Ai, lum Rina, nuk matet me at njsí mase gjeometrike qi ti kujton se është palci i urtís njerzore. Ai hÿn në radhën e shÿjtÿnvet e të herojvet qi mbajnë synin e ngulun në dritë të një qelli-mi të lartë edhe thejnë e coptojnë normat e ngushta të jetës s'onë të rendomtë pa shkase fluturimesh e pa shkëndija pÿrlartësimesh. (*Ftoftas e prëmas*) Unë e due njashtu si është jo ndryshej...

RINA Jeni të çmendun të dy. Fola për të mirën t'ande. Ti bân si t'a presin mendja.

KOSTANTINI Tashti lëni fjalët e thirrnje sherbëtores të na shtrojë sofrën. (*Rina del nga e mbajta*).

SERAFINA Unë e due...

KOSTANTINI E dij!

SERAFINA Ajo pse m'a gandon zëmrën me fjalë kote?

KOSTANTINI Pse matematika qi i a ka mbushë rradakën fund e maje nuk e lën me i kuptue sendet mâ të thjeshta. Rend, rregull, pÿrpikni, — dÿ e dÿ bájne katër. Me pasë bâ katër dÿ e dÿ për Gurakuqin, kurr Shqipnija s'kishte dalë në dritë. Për të e për idealista, dÿ e dÿ bájne njimí ase njiqindmí, sepse ata kanë dhuratën taumaturgjike me i shëndrrue àndrrat në realitet. Ti mos i vën vesh fjalve të Rinës. E mos u idhënò me të. E ndien veten të detyrueme me të këshillue si motër mâ e madhe qi është. T'a don të mirën. Natyrisht një të mirë... katërcipisht të mÿrthyeme në rregulla gjeometrike qi tý kishte me të mjerue...

SERAFINA (*buzqeshë e del kah e mbajta tue thànë:*) Kë arsye! s'duhet me i a marrë për të keq.

(*Sherbëtorja hÿn me një turrë çinijash e me lugë e thika e pirûj vndue sipër një tabakje së madhe. Rina bjen gotat e krypcën edhe ndihmon me pregatitë tryezën. Vren a është shtrûe sofrabezi në mënyrë qi kindat me rá të njájtë sa këndeje andej, i a ndreqë vendin çinijave, të vÿme prej sherbëtores, tue i rendue me simetri të pÿrpikët. Kostantini i shtrím në poltronë lexon një fletore qi ka nxjerrë nga shtjeku i setres*).

KOSTANTINI (*në një ças qi sherbëtorja ka dalë*) Nuk duhet t'i flitish ashtu Serafinës. Æsht e ndieshme: fjala mâ e vogël i a lëndon shpirtin.

RINA (*fshân*) E dij. S'mund e ndala veten. E marr vesht se gabova. Më dhimbet pse s'ka pasë fat në jetë. E don Luigjin. Shpresojmë qi vertë në verë të shifen e t'a skjarojnë punën e tyne. Mbasí qi ajo është e bindun se vetëm tue u lidhë me të siguron një jetë të lume, kjoftë bâ vullneti i saj.

KOSTANTINI (*pa çue sÿt nga fletorja*) Tash ké folë për s'mbarit!

RINA (*Kostantini*) Æsht gati. (*Sherbëtores qi ka sjell shishen e vënës e bocën e ujit*) Thirre Serafinën.

KOSTANTINI Shka po na bân me hangër nesër mbrama qi vjen Luigji?

RINA S'dij as unë. Kam mësim paradite e mbasdite...

SERAFINA (*tue hÿ ka ndëgjue at bisedë*) Mos bërnij kujdes. Nesër po hÿ vetë n'odë të zjarmit e po i pregatis gjellat qi e dij se i a kande. Njihërë « filjiljt »... Delte mendsh mbas tynë në Shën Mitër! Mandej, po dal heret në mëngjes, në mujsha me gjetë do peshk të mirë e po i pregatis një tavë shkodrancelë.

KOSTANTINI Me këto argumenta t'a dijësh se e binde me t'ardhë pa tjetër në Shën Mitër...

SERAFINA Ai është poet. Gjellën ai nuk e shijon vetëm me gojë. Disa gjellë i ngjallin kujtime të harrueme. Për shembull, filjiljt i a përtrijnë në mende kohën e rinis qi kaloi në Shën Mitër: shtëpin t'onë, kolegjin e Shën Adrjanit, shokët e shkollës. Shija e asaj gjelle përzihet me ambëlsí qi ngjarjet e kalesës i dhurojnë shpirtit të tij të trazuem nga vishtirsít e së tashmes. Tava e peshkut me qepë i kujton Shkodrën, rrethin shtëpijak, mbledhjet me miq. E malle-ngjen, por edhe e ngushullon.

RINA Shifet se kë marrë doktoratën në letrësi...

SERAFINA Ndi jet, kunat i dashun, m'i ka hollue mâ tepër Luigji se profesorat e Universitetit.

(*Bjen telefoni*).

SHERBËTORJA (*shkon tu aparati, vën zãmarrsin në vesh*) Për jue, zoti Advokat. Æsht ortaku i juej, Di Salvo.

KOSTANTINI (*çohet e kapë telefonin*) Vito, ti jé? Mirë mbrá... Si? Shka jé kah thue, bre?! S'është e mundun! S'ka si me kënë! Ndo dhesh para Hotelit «Cavour»? Po vî menjihërë.

SERAFINA (*e trembun*) Shka ka ndodhë... para Hotelit «Cavour»?

KOSTANTINI Kurr gjá... Di Salvo... Sigurisht ka marrë vesht keq.

SERAFINA Po shka, pash fën, shka ka ndodhë? Jé zbé në fytyrë... Të dridhet buza... (*vrret*) Pásh Zotin, më kallzò shka ká ndodhë...

RINA (*edhe ajo e shqetësue me*) Shka tha Di Salvo?

KOSTANTINI (*niset kah dera e djathtë*) Po dal e marr vesht. S'është e mundun...

SERAFINA Shka s'është e mundun?...

RINA Fol. A nuk shef se po dalim mendësh?

KOSTANTINI (*me zâ të shkyem*) Kanë gjuejtë në pushkë Luigjin...

SERAFINA Jo, jo... Ah, Zot! (*s'e mbajnë kâmbët. Rina nget kah ajo, e kapë para se të rrëzohej për tokë dhe, e ndihmueme prej të shojt, e mbështetë në divan*).

RINA (*sherbëtores mësa me dorë i a ferkon ballin së motrës*) Vrap m'a sjell shishëzen me érna qi kam mbi komoh n'odë të fjetjes... (*Sherbëtorja del tue ngá*) Kostantin... (*me zâ t'ultë plot ngashërim*) a është plagosë randë?...

KOSTANTINI (*tue shì djersët e ftofta në ball me shamí, pershpëritë*) E ka vrá dekun, ai i mallkuem!

RINA (*Shpërthen në vaj*) Mos! I patenzoni! I u thaftë dora, i u thaftë! si na thau zëmrat né...

KOSTANTINI Po shkoj. Due t'a shof...

RINA (*tue i a afrue te hunda së motrës shishezën me érna qi ká sjellë sherbëtorja, i thotë burrit me një fije zânit*) Prit, duhet me i a kallzue dal-kadalë kësaj. Æsht rrezik kur t'a marri vesht, se i bjen, ruena Zot!, ndoj send...

SERAFINA (*tue këthye në vete ka ndëgjue fjalët e së motrës*) Kukú!
Ah, Luigj! Ah, kërcuna unë!

RINA (*i a lëmon flokët mësa lotja i shkon edhe asaj rrëkaj faqevet*)
Ndoshta s'e ka randë e shpëton. Mos u mjerò kështu. Njome e jeme!
Vogëlusha e nânës. (*E përqafoi edhe e puthë*).

SERAFINA (*rraset në krahë të motrës si me gjetë mproje*) Ah, Luigj
orëprém! Ah, rrezikzeza unë! (*Flet si në kllapí*) Pse nuk u ndale
këtu? «Kam një takim qi s'mundem m'e shtëy...» Kështu thae e
shkove me u takue në Vdekjen mizore. Unë t'u luta «Pushò në par-
zëm t'em. Jam jesteku i butë i yti». Nuk të ndaloi dashuniya e
eme. Tashti të pushon kryet në prëhen të ngritë të Mordes. (*Qán
për do kohë. Rina vazhdon t'i a lëmojë lehtas flokët. Papritmas ajo
çohet ndejun e i siellet Kostantinít*) Shko e shife. Por mos më kall-
zò si duket ashtu i ngrím në paluejtësi të dekës. Sepse...

KOSTANTINI Sepse?

SERAFINA ...sepse unë s'due t'a mendoj me krye të mbështetun në
jestek.... n'asnji jestek... U gënjeva tue kujtue se ai do të mund
të pushonte në prëhen t'em! Ai ishte duhí ndiesish qi nuk njeft pu-
shim... flámur qi rreh paprá n'ërna të historís... E unë mbas tashit
due t'a shof si e shifshem ndër ándrra të njoma të fëminís s'eme:
prís qi nuk përkulë vdekja... prís qi udhëheq Shqiptarët nepër
rrjedhje të qindvjetave për t'u kallzue vadat e lavdís... (*I shëndri-
sin sýt e përlotun si të grabitun nga një vegim plot dritë*).

SHPIË S'IME

*Te ti m'flutron mendimi, o shpiza e ime,
Kur vjen má i thershtëm malli me m'trazue;
Te ti, ku nisa s'parit me jetue,
Ku çila sýt, ku leva e pata gzime.*

*Gjith her' ndër mend t'kam ty, ku laç' kujtime
T'ámbla, qi jetën m'pan' një ditë gazmue;
Vetëm n'dhé t'huej, tue vuejtë e tue lingue,
T kam n'zëmër ty, ku ndjeva t'par't dashtnime.*

*Ai skáj má i vogli i yt, má e vogla skutë
E jotja ka per mue aq ambëlsi,
Sa veç kujtimi i tyne shpirtin m'kputë.*

*E kur me rá shkoj n'mbrame me mjeri
Ty t'mendoj, e i tham vedit: oh á má i butë
Shtrati, e má i kardshëm á pushimi n'shpi!...*

LUIGJ GURAKUQI
Nga vepra e Gjìkam:

« Vjerrsha të Luigj Gurakuqit »
Bari, 1940 - (Faqe 49)

Rapsodija e nuses së mbrapësht

nga TUSH MURGU

Dy jetima t'vogjël kishin mbetë,
Njani djalë e tjetra vajzë.
Nana e baba t'shkretve u kish'dekë,
Shkojshin jetën me shumë gazep.
Kur i mbushën njizet vjet,
Shka i ka thënë motra vllaut t'vet:
« Un një punë e kam mendue:
Sa t'jemë gjall mos me u martue! »
Ç'ka qitë vllau motërs i ka thënë:
« Besën e Zotit, motër, me m'a dhanë,
Me m'ruejtë erzin mue e t'tanë shoqnis,
Me i ruejtë erzin nanës edhe babës,
Qi po kalben, t'shkretit, në dhë t'zi. »
Ç'ka qitë motra vllaut e i ka thënë:
« Besën e Zotit, vllá, t'a kam dhanë;
Kam ruejtë erzin ty e t'tanë shoqnis,
U kam ruejtë erzin nanës edhe babës.
Qi po kalben sot në dhë të zi. »

Mbas do ditësh qi kanë kalue,
Motër shkreta n'kambë á çue,
Besa vllán e ka martue.
Zëmër zezë nusja ka qillue.
Dumbdhet muej kur panë kalue,
Ja u kish falë Zoti një djalë,
Ja u kish falë për bukuri,
Shum lezet m'e pa me sy.
Nuse shaka çka ka punue:
Ditë për ditë burrin tu'e prozhmue:
« Pse kit motër z'don m'e martue?!
Vajza n'shpi á plehë për gjini! »
« Hajt, moj grú, s'á punë për ty. »

Mbas do ditësh qi panë kalue,
Nuse shaka shka ka punue:
Para dritet n'kambë á çue,
E ka marrë një thikë në dorë,
Dalë-kadalë á ulë për shkallë,
Kalit t'shalës i asht afrue,
Thikën n'bark kalit ja ka vû,
Zorrtë në tokë të tana ja ká lëshu,
E për shkallësh nusja ka shku,
Për pa dije burri as kunata.
S'e kan ndije, s'e kan pa,

Dalë-kadalë nusja n'shtrat ka ra.
Kur ka ndisë drita me agu,
Nuse qyqja n'kambë â çu,
Merr konopin, te sana ka shku.
Mirë me sanë nusja asht ngarku,
Sanën n'ahër nusja e ka çu,
Po bërtet t'madhe: kukú!
« More burrë, të plaçin sytë e ballit,
Mirë e bânkan sante t'zezen e kalit.
Shka kan bâ miqtë e motërs s'ate:
Na e kan premun kalin e shalës!
Shum të thashë e ti nuk m'ndigjove,
E kët motër kurr s'e martove.»
Shká qitë djali nuses e i ka thanë:
« Paça vedin e paça motrën,
Se e blej kalin t'shpejtë e t'mirë.»

Mbas do ditësh qi panë kalue,
Nuse shaka shka ka punue:
Para dritet n'kambë â çue
E e ka marrë një thikë në dorë,
Dalë-kadalë â ulë për shkallë,
Ndërmjët qevet na u ka shku,
Thikën n'bark t'dyve ja u ka vù,
Zorrtë në tokë të dyve ja u ka lëshu!
E për shkallësh nusja ka shku,
Për pa ndije kush e për pa pa,
Dalë-kadalë në shtrat ka ra.
Kur ka ndisë drita me agu,
Nuse shaka n'kambë â çu,
Merr konopin te saná ka shku,
Mirë me sandë nusja â ngarku,
Sanën n'ahër e ka çu.
Po bërtet t'madhe: kuku!
« More burrë të plaçin sytë e ballit!
Mirë n'ê fikën derën e konakut:
Na i kan pré t'dy qetë e kularit!
Shka kan bâ miqtë e motërs s'ate!
Shum të thashë e nuk m'ndigjove
E kët motër kurr s'e martove.»
Shká qitë djali nuses e i ka thânë:
« Paça vedin e paça motrën,
Se i blej un qetë shpejt e t'mirë.»

Mbas do ditësh qi panë kalue,
Nuse shaka shká punue:
Ka marrë djepin e e ka afrue,
Thikën n'qafë djalit ja ka vù,
E ka pré nana djalin e vet!
Si e si kunatën m'e tretë.
Kur ka ndisë drita me agu,

Nuse zeza n'kambë â çu,
 Ka marrë djepin n'gjuj e ka vû,
 Për me i dhanë djalit me pi.
 More burrë, po báj çudi,
 Si s'na kján sante ky fmi!?
 Asnji natë s'ka bâ vakí.
 Kur ka ndisë djalín m'e zblu,
 Po bërtet t'madhe: kuku!
 « More burrë, të plaçin sytë e ballit!
 Mirë ja bâkan t'zezën djalit!
 Shka kan bâ miqtë e motërs s'ate.
 Shum të thashë e nuk m'ndigjove,
 Motër dreqin s'e martove.
 Na kan bâ mâ t'madhin gazep:
 Na e kan prë djalín në djep!
 Aterë djali n'kambë â çu,
 Fíll n'odë motërs i ka shku:
 « Çou, moj motër, mos pritsh m'u çu!
 Nuk paçë dert për kalin e shalës,
 As s'paçë dert për qetë e kularit,
 Vdekja e djalit m'plasi sytë e ballit! »
 Motër shkreta n'kambë â çu,
 Lotët n'tokë të shkretës i kan pshtu.
 Asnji fjale s'ka kuvendu.
 Ka marrë motrën n'oborr e ka çu,
 N'vithe t'kalit t'shkretën e ka vû,
 Për një rryp lidhë e shtërngu
 E i ka hypë kalit, ndisë e shku.
 Hânën e hiellun e ka kalu,
 Në breg t'detit janë ndalu.
 Mendon vllau shka me i punu:
 A m'e vrá, a n'dét m'e lëshu.
 Nji sukë n'dét kish pas qillu,
 Sukë e zezë të tanë gërrlata,
 S'kish me ngranë as s'kish me pi,
